Konrad Adenauer Stiftung

MANUAL PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË TË VITIT 2013

INSTITUTI PËR DEMOKRACI
"SOCIETAS CIVILIS" – SHKUP

POLITIKË

MANUAL PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË TË VITIT 2013

MANUAL PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË TË VITIT 2013

Ilina Mangova
Jovan Bliznakovski
Aleksandar Talimxhioski
me kontributin e
Aleksandra Murgoska

Impresum

Titulli:
Manual për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Maqedonisë të vitit 2013

Editor:
Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë
Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup

Autorë:
Ilina Mangova / Jovan Bliznakovski / Aleksandar Talimxhioski me kontributin e Aleksandra Murgoska

Koordinimi:
Davor Pashoski

Përktheu në gjuhën shqipe:
Blerina Starova Zllatku

Disenji dhe përgatitja:
Vinsent Grafika

Publikimi mund të shkarkohet falas në:
http://www.kas.de/mazedonien

Shënim:

Qëndrimet e prezantuara në këtë publikim nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer dhe të Institutit për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, por janë pikëpamje personale të autorëve.

Përmbajtja:

1. Hyrje në Zgjedhjet Lokale të vitit 2013 8

Përgatitje për Zgjedhjet Lokale të vitit 2013 16

Historiku i zgjedhjeve lokale në Maqedoni 26

2. Sistemi zgjedhor maqedonas për zgjedhjet lokale 32

Modeli zgjedhor 33

Organet për zbatimin e zgjedhjeve 34

E drejta për t'u zgjedhur 36

Kufizime për funksionarët aktual – kandidatë për kryetarë të komunave ose këshilltarë 37

Numri i anëtarëve në këshilla 38

E drejta dhe procedura për paraqitjen e kandidaturave për kryetarë të komunave dhe listave për këshilltarë 38

Fushata zgjedhore 39

Roli i mjeteve të informimit publik 40

Vëzhgimi i zgjedhjeve 40

3. Partitë dhe koalicionet politike 42

VMRO – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) 43

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM) 45

Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) 47

Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) 48

Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) 50

Unioni Social-Demokratik (USD) 50

Partia Social-Demokratike e Maqedonisë (PSDM) 51

Lëvizja Popullore e Maqedonisë (LPM) 52

Forcat e Bashkuara Demokratike të Romëve (FBDR) 52

Lidhja e Romëve të Maqedonisë (LRM) 53

Partia Përparimtare Serbe në Maqedoni (PPSM) 53

Koalicione 54

„Aleanca për Ardhmëri" 54

„Për Maqedoni më të Mirë" 55

4. Pasqyra e kandidatëve për kryetarë të komunave në Zgjedhjet Lokale 2013 56

5. Burime të shfrytëzuara 120

HYRJE NË ZGJEDHJETLOKALE TË V ITIT 2013

HYRJE NË ZGJEDHJET LOKALE TË V ITIT 2013

Më 24 mars të vitit 2013 do të mbahen zgjedhjet lokale, të pestat me radhë në Republikën e pavarur të Maqedonisë. Për pushtetin lokal do të garojnë 341 kandidatë për kryetarë të komunave dhe 451 lista të këshilltarëve.

Gjatë mandatit të fundit të vetëqeverisjes lokale, nga muaji mars të vitit 2009, deri në mars të vitit 2013, numri më i madh i vendeve të kryetarëve të komunave i takonin partisë në pushtet - Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (OBRM-PDUKM/VMRO-DPMNE), e cila fitoi 56 vende të kryetarëve të komunave dhe 460 vende të këshilltarëve. Partia e dytë më e suksesshme, sa u përket vendeve të kryetarëve të komunave në ato zgjedhje, ishte Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), e cila fitoi 15 vende të kryetarëve të komunave (një vend në kuadër të koalicionit) dhe 179 vende të këshilltarëve. LSDM ka fituar vende të kryetarëve të komunave në 7 komuna,[1] ndërkaq në zgjedhjet e vitit 2009 fitoi 282 vende të këshilltarëve. Partia e dytë për nga madhësia në mesin e elektoratit shqiptar, Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) fitoi një vend të kryetarit të komunës dhe 52 vende të këshilltarëve. Përveç këtyre partive, nga një kryetar komune u zgjodh nga Demokracia e Re, Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni, Lidhja e Romëve, Partia Radikale e Serbëve në Maqedoni dhe dy kryetarë të pavarur të komunave.[2] Së këtejmi, VMRO-DPMNE nga viti 2006 është në pushtet në nivel nacional pas fitoreve në dy zgjedhjet e parakohshme të njëpasnjëshme parlamentare, më 1 qershor të vitit 2008 dhe më 5 qershor të vitit 2011.

[1] Kah fundi i mandatit, më datë 17 shkurt të vitit 2013, për shkak të mosrespektimit të vendimit për bojkotimin e zgjedhjeve dhe paraqitjes së kandidaturës nën patronazhin e Partisë Përparimtare Serbe, njëri nga shtatë kryetarët e komunave, Stevço Jakimovski u përjashtua nga LSDM.

[2] OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights. The former Yugoslav Republic of Macedonia Presidential and Municipal Elections 22 March and 5 April 2009. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, June 2009.

Për këto zgjedhje hyn në fuqi ndryshimi i organizimit territorial të vetëqeverisjes lokale që ishte parashikuar me Ligjin për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale nga viti 2004, ndërsa më pas i prolonguar me ndryshimet e bëra në muajin gusht të vitit 2008.[3] Në vitin 2012 komunat Vraneshticë, Zajaz, Drugovë dhe Osllomej u bënë pjesë të Komunës Kërçovë, me ç'rast numri i njësive të vetëqeverisjes lokale (NJVL) në Maqedoni u zvogëlua nga 85 në 81.

Zgjedhjet lokale mbahen pas krizës politike dymujore në të cilën u fut Maqedonia gjatë miratimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2013. Përkatësisht, partitë opozitare parlamentare LSDM, PDSH dhe Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) e zbatuan modelin filibastering që ta pamundësojnë miratimin e Propozim-Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2013. Këto parti propozuan gjithsej 1225 amendamente pranë Komisionit për Financa dhe Buxhet. Opozita parlamentare e akuzoi Qeverinë se me Buxhetin e propozuar do ta ngarkojë shtetin me kredi, të cilët duke e përfshirë edhe vitin e ardhshëm do ta arrinin një shifër të borxhit prej 600 milionë euro. Gjithashtu, sipas opozitës Buxheti është dedikuar për "blerje parazgjedhore të votave të pensionistëve, shfrytëzuesve të ndihmës sociale".[4] Nga ana tjetër, deputetët e PDSH dhe RDK e akuzuan Qeverinë se Buxheti është krijuar në favor të bashkësisë etnike maqedonase dhe i njëjti e diskriminon bashkësinë etnike shqiptare.[5] Të përballur me mundësinë që Buxheti të mos miratohet me kohë,[6] Komisioni Juridik-Ligjvënës filloi me mbledhjen për amendamentet e paraqitura, gjë që sipas nenit 79 të Rregullores së

3 Ligji për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 55/04 nga 16.08.2004"; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 98/08 nga 04.08.2008.

4 *Mitevska, M. "Buxhet real ose parazgjedhor?", Radio Evropa e Lirë, 19 nëntor 2012.*

5 *"BDI ta bllokojë miratimin e Buxhetit joshqiptar", Kapital, 20 dhjetor 2012; dhe I.M. "Buxheti 2013: për VMRO është zhvillimor, për LDSM është parazgjedhor, për RDK është etnik!". Faktor,* 19.11.2012.

6 Sipas Ligjit për Buxhete, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 64, 03.08.2005, Buxheti i Republikës së Maqedonisë duhet të miratohet deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës. Nëse një gjë e këtillë nuk ndodhë, ky afat prolongohet deri më datë 31 mars të vitit të ardhshëm, periudhë në të cilën në bazë të pëlqimit nga Ministria e Financave, mund të shfrytëzohen mjete në shumë prej një të tretës nga shpenzimet e bëra në tremujorin e parë të vitit paraprak.

Kuvendit duhet të zhvillohet pasi që të shqyrtohen amendamentet në Komisionin amë.[7] Për këtë shkak, deputetët e opozitës filluan ta pengojnë dhe ta pamundësojnë punën e Komisionit Juridik-Ligjvënës dhe e akuzuan shumicën për shkelje të Rregullores së Kuvendit.[8] Më datë 22 dhjetor të vitit 2012, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë iu dërguan raporte nga Komisioni për Financa dhe Buxhet dhe nga Komisioni Juridik-Ligjvënës në lidhje me Propozim-Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2013. Raporti i parë u nënshkrua nga deputetët e shumicës së partive në pushtet, me ç'rast jepet njoftim për ngjarjet në Komision, votimin në Komision sa u përket amendamenteve nga 1 deri në 161 dhe për amendamentet e tjerë nga 161 deri në 1225 dhe se është lexuar prononcimi me shkrim i Qeverisë së RM-së.[9] Raporti i dytë u nënshkrua nga kryetarja e Komisionit, e cila njoftoi se Komisioni i ka shqyrtuar amendamentet nga 1 deri në 137, ndërkaq për amendamentet e tjerë deri në 1225 për shkak të pengimit nga ana e deputetëve të opozitës dhe për shkak të mospasjes së kushteve për punë, është lexuar prononcimi me shkrim i Qeverisë.[10] Këto raporte Kryetari i Kuvendit ia dërgoi Qeverisë, e cila më datë 23 dhjetor e miratoi Buxhetin e plotësuar dhe ia dërgoi Kuvendit për votim.[11]

Më datë 24 dhjetor të vitit 2012, Buxheti u vendos për votim në Rendin e ditës të seancës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe deputetët e opozitës filluan ta pengojnë punën e Kuvendit. Pas një sërë incidentesh, sigurimi i Kuvendit i largoi nga Kuvendi deputetët e opozitës të "Aleancës për ardhmëri". Pas kësaj, Buxheti u miratua nga deputetët e mazhorancës parlamentare, ndërkaq opozita nga "Aleanca për ardhmëri" filloi t'i bojkotojë punimet e Kuvendit, filloi me protesta të rregullta dhe bëri thirrje për zgjedhje të parakohshme parlamentare. RDK, e cila ka dy deputetë, pas kësaj ngjarje, gjithashtu për një kohë të shkurtër i bojkotoi punimet e Kuvendit, kështu që PDSH ishte partia e vetme opozitare e cila

7 *Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* 130/2010

8 *"Atmosferë e tensionuar në Komisionin Juridik-Ligjvënës". "24 Vesti",* 22.12.2012.

9 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Raport nga mbledhja nr. 43 *e Komisionit për Financa dhe Buxhet e mbajtur më datë 22.12.2012.*

10 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Raport nga mbledhja nr. 70 e *Komisionit Juridik-Ligjvënës, e mbajtur më datë* 22.12.2012.

11 *"Buxheti u miratua dhe u dërgua në Kuvend", "Sitel"* 23 dhjetor 2012.

merrte pjesë në punimet e Kuvendit.[12] Gjatë ditës së njëjtë, gazetarët e angazhuar të informojnë nga Kuvendi i RM-së u përjashtuan nga Galeria nga e cila i ndjekin aktivitetet e Kuvendit, për çka kishte reagim dhe protestë të përbashkët nga ana e organizatave mediatike në Maqedoni.[13]

Maqedonia është vend kandidat për BE nga 17 dhjetori i vitit 2005, por akoma nuk i ka filluar negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Progres raportet, që i përgatit Komisioni Evropian, katër vjet radhas rekomandojnë fillimin e negociatave, por për një gjë të këtillë nuk ka pëlqim nga Këshilli Evropian, prandaj akoma nuk na është caktuar data për fillimin e negociatave. Problem kyç për fillimin e negociatave është kontesti për emrin, të cilin Republika e Maqedonisë e ka me Republikën e Greqisë. Në mungesë të fillimit të negociatave për aderim në BE u vendos mekanizmi Dialogu aderues i nivelit të lartë, i cili u fokusua në reforma konkrete në fushat kryesore prioritare. Përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, si dhe përfaqësuesit e tjerë të faktorit ndërkombëtar, gjithashtu u përfshinë me angazhimet e tyre dhe disa herë e vizituan Maqedoninë dhe zhvilluan biseda me liderët politikë në drejtim të vendosjes së dialogut ndërmjet pushtetit dhe opozitës me qëllim të zgjidhjes së krizës aktuale politike. Kriza u thellua kur deri në skadimin e afatit për paraqitjen e kandidaturave për zgjedhjet lokale, 16 shkurt i vitit 2013, koalicioni opozitar i udhëhequr nga LSDM nuk nominoi kandidatë të vetë, me çka u realizua bojkoti paraprakisht i paralajmëruar i zgjedhjeve. Më datë 26 shkurt të vitit 2013, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me propozim të Qeverisë, iu qas ndryshimit të Kodit Zgjedhor me procedurë urgjente, me të cilin u prolongua periudha e paraqitjes së listave të kandidatëve për anëtarë të këshillave dhe listave për kryetarë të komunave nga ana e të gjitha subjekteve të cilët nuk i janë përmbajtur afatit të përcaktuar ligjor.[14] Me këtë ndryshim afati i paraqitjes së listave të kandidatëve u prolongua deri më datë 3 mars të vitit 2013. Më 1 mars të vitit 2013 delegacioni evropian në krye me Komisarin për Zgjerim dhe Politika Fqinjësore të Komisionit Evropian, Shtefan Fyle, deputetin e Parlamentit Evropian dhe raportues për Republikën e Maqedonisë, Riçard Hovit dhe deputetin e Parlamentit Evropian nga Partia Popullore Evropiane Jirzhi Buzek, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Maqedonisë Dr. Gjorge Ivanov i bënë përpjekjet e tyre të fundit dhe të suksesshme që të arrijnë marrëveshje ndërmjet dy partive më të mëdha politike në Maqedoni. Me ndërmjetësimin e këtyre përfaqësuesve të lartë të Bashkimit Evropian u arrit marrëveshje ndërmjet VMRO-DPMNE dhe LSDM si rezultat i së cilës LSDM ra dakord që të marrë pjesë në zgjedhjet lokale. Në kuadër të këtyre bisedimeve të dyja partitë ranë dakord:

"të mbështeten prioritetet strategjike të shtetit:

përmes Memorandumit për Mirëkuptim ndërpartiak (ose Rezolutës Parlamentare), me të cilin konfirmohet mbështetja e agjendës për Integrimet Euroatlantike, si dhe të bëhen angazhime për t'u përmbajtur nga veprimet që do ta rrënonin këtë qëllim.

Të rivendoset jeta normale politike:

Të gjitha partitë të kthehen në Parlament dhe të marrin pjesë në Zgjedhjet e caktuara Lokale

Të mbështeten masat kryesore reformiste të drejtpërdrejta, përfshirë edhe:

- përmirësimin e funksionimit të Parlamentit, duke e përfshirë edhe nismën e Presidentit që të thërrasë ad-hok Komision Anketues (që mes tjerash të shqyrtohen edhe ngjarjet para dhe të 24 dhjetorit, përfshirë edhe kushtetutshmërinë e tyre, sigurinë brenda dhe jashtë Parlamentit dhe revizionin e rregullave procedurale të Parlamentit), rezultatet e të cilit do të pasqyrohen në Raportin e Komisionit për progresin e arritur në vjeshtë të vitit 2013.
- reformën zgjedhore, pas Zgjedhjeve Lokale, duke e përfshirë edhe Regjistrin e Zgjedhësve (për shembull, revizion të listës pas zgjedhjeve) dhe rekomandimet e tjera të OSBE/ODIHR.

12 Më vonë, gjatë muajit janar, deputetët e RDK e ndërprenë bojkotin dhe iu bashkëngjitën punimeve në Parlament. "RDK u kthye në Parlament" "Dnevnik", 23.01.2013.

13 *Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. Deklaratë e përbashkët e organizatave mediatike për incidentin në Kuvend,* 27 dhjetor të vitit 2012.

14 *Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Propozim-ligj për plotësimin e Kodit Zgjedhor, me procedurë urgjente (leximi i dytë).* 26 shkurt të vitit 2013.

- lirinë e të shprehurit, për shembull, rivendosjen e dialogut me gazetarët, të udhëhequr nga Shoqata e Gazetarëve, si dhe masa të tjera për ndërtimin e mirëbesimit.

  për kalendarin e zgjedhjeve:

  të jepet kohë përkatëse që të regjistrohen listat e kandidatëve për Zgjedhjet

  të mblidhen menjëherë pas Zgjedhjeve Lokale që të diskutohet situata e brendshme politike, përfshirë edhe konstatimet e Komisionit Anketues për ngjarjet e 24 dhjetorit dhe të vazhdojnë diskutimet, me vullnet të mirë, për të gjitha opsionet dhe pa paragjykime për përcaktimin e kornizës kohore për zgjedhjet e ardhme parlamentare, në bazë të zbatimit të rekomandimeve të OSBE/ODIHR, me qëllim që rezultatet të mund të merren parasysh në Raportin e ardhshëm të Komisionit për progresin e arritur.

  BE:

  Të konvokohet mbledhja e katërt e HLAD me Komisionin Evropian (mars), në të cilën do të përfshihet edhe Qeveria edhe Këshilli Nacional për Eurointegrime.

  Komisioni Evropian ta prezantojë Raportin e vet, ashtu siç u kërkua nga Këshilli, deri në mesin e muajit prill.

  Parlamenti Evropian të caktojë votim për Raportin e vet në një kuadër pozitiv dhe konstruktiv” [15]

Si rezultat i kësaj marrëveshjeje më 2 mars të vitit 2013 deputetët e opozitës u kthyen në Kuvend ndërsa Kodi Zgjedhor sërish u ndryshua, përkatësisht afati i paraqitjes së kandidatëve u prolongua deri më 8 mars të vitit 2013.[16]

[15] Deklaratë e përbashkët e: Komisarit për Zgjerim dhe Politika të Mira Fqinjësore- Shtefan Fyle, Referuesit të Parlamentit Evropian për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë- Riçard Hovit dhe ish-Kryetarit të Parlamentit Evropian-Jerzhi Buzek, gjatë misionit të tyre në Shkup, më 1 mars të vitit 2013. E arritshme më 11.03.2013: http://ec.europa.eu/commission_2010-2014/fule/headlines/news/2013/03/20130301_en.htm

[16] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Propozim-ligj për plotësimin e Kodit Zgjedhor, me procedurë urgjente, 2 mars viti 2013. I arritshëm më 06.03.2013: http://www.sobranie.mk/ext/materialdetails.aspx?Id=a8c87be7-1d6f-4c88-bcd9-6906b2bb4b32

Pjesëmarrës në zgjedhje

Në Zgjedhjet Lokale, në mënyrë të pavarur ose në koalicion, si paraqitës të listave të kandidatëve për kryetarë të komunave paraqiten 15 parti politike, por asnjëra nuk nominoi kandidatë për kryetarë të komunave në të gjitha 81 njësitë e vetëqeverisjes lokale. Nga partitë më aktive parlamentare VMRO-DPMNE me koalicionin e vet ka nominuar 68 kandidatë për kryetarë të komunave, nga të cilët 5 janë femra, koalicioni i udhëhequr nga LSDM ka nominuar 67 kandidatë për kryetarë të komunave prej të cilëve 4 janë femra. BDI ka nominuar 23 kandidatë për kryetarë të komunave prej të cilëve vetëm një është femër, PDSH ka nominaur 27 kandidatë për kryetarë të komuna prej të cilëve, po ashtu, vetëm një grua, ndërkaq RDK ka nominuar 14 kandidatë (një në koalicion) për kryetarë të komunave, prej të cilëve asnjë femër. Prej gjithsej 341 kandidatëve për kryetarë të komunave, vetëm 29 janë femra (9.4%). Për dallim nga norma ligjore, e cila i obligon partitë që çdo kandidat i tretë, në listat e propozuara për kandidatë për këshilltarë, të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar, një obligim i këtillë nuk parashikohet për kandidatët për kryetarë të komunave. Të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje e kanë përmbushur këtë kusht, duke e marrë parasysh atë që nëse obligimet ligjore nuk përmbushen, atëherë administrata zgjedhore do ta hedhë poshtë listën. Përveç këtyre partive, me kandidatë të tyre për kryetarë të komunave në këto zgjedhje, marrin pjesë edhe parti të vogla politike si Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PTM), Lëvizja Popullore e Maqedonisë (LPM), Forcat e Bashkuara Demokratike të Romëve (FBDR), Partia për Ardhmëri Evropiane (PAE), Partia Social-Demokratike (PSDM), Unioni Social-Demokratik (USD), Lidhja e Romëve të Maqedonisë (LRM) dhe Partia Përparimtare Serbe e Maqedonisë (PPSM). Gjithashtu, janë paraqitur edhe 27 lista të kandidatëve për kryetarë të komunave të mbështetur nga grup zgjedhësish. Po ashtu, janë paraqitur edhe 84 lista të kandidatëve për këshilltarë nga grupe të zgjedhësve.

PËRGATITJE PËR ZGJEDHJET LOKALE 2013

Para se të fillojë fushata zgjedhore, disa parti filluan t'i promovojnë disa nga kandidatët e tyre për kryetarë të komunave dhe këshilltarë. LSDM dhe koalicioni i promovoi kandidatët për kryetarë të komunave të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit më datë 26 tetor të vitit 2012.[17] Para vendimit për bojkotimin e zgjedhjeve lokale ky koalicion promovoi 21 kandidatë, ndërsa deri në arritjen e marrëveshjes politike nuk u promovuan kandidatë të rinj. Koalicioni i VMRO-DPMNE kandidatët e vetë për kryetarë të komunave filloi t'i promovojë në dhjetor të vitit 2012, disa nga kandidatët e BDI-së u promovuan publikisht në janar të vitit 2013, ndërkaq disa kandidatë të PDSH-së për kryetarë të komunave u përcaktuan qysh në korrik të vitit 2012. Edhe pse fushata zgjedhore zyrtarisht fillon më 4 mars të vitit 2013, partitë të cilat deri më tani promovuan kandidatë, filluan edhe me aktivitete promovuese. Të gjitha partitë e praktikojnë publikimin gradual të emrave të kandidatëve.

Në periudhën kohore nga data 26 janar deri më datë 9 shkurt **Lista e Zgjedhësve** ishte në këqyrje publike, me ç'rast çdo qytetar kishte mundësi ta kontrollojë situatën e të dhënave të tij. Lista e Zgjedhësve i përfshinë të gjithë qytetarët e moshës madhore (mbi 18 vjeç) me vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë, të cilët posedojnë dokumente personale biometrike. Gjithashtu, në Listën e Zgjedhësve u regjistruan shtetasit e RM-së të cilët janë me qëndrim ose me punë të përkohshëm jashtë vendit, por të cilët posedojnë dokumente të vlefshme udhëtimi.

Lista e Zgjedhësve, një kohë të gjatë ishte në shënjestër të kritikave dhe vërejtjeve të OSBE/ODIHR, të partive politike dhe publikut. Kritikohej kualiteti dhe autenticiteti i Listës së Zgjedhësve, e cila në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011 numëronte 1 821 122 votues dhe kërkohej rishikimi i saj. Në muajin mars të vitit 2012, në kuadër të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, u formua Grupi Punues për Verifikimin e Listës së Zgjedhësve, i cili kishte për qëllim ta azhurnojë Listën e Zgjedhësve sa u përket personave që kanë ndërruar jetë, personave – shtetas të RM-së të cilët jetojnë jashtë vendit dhe personave të cilët posedojnë dokumente të vlefshme personale. Përkrah anëtarëve të KSHZ-së, Grupin Punues e përbëjnë përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të partive më të mëdha politike, si dhe përfaqësues të organizatave vendase dhe ndërkombëtare. Grupi Punues konstatoi se Lista e Zgjedhësve, e qytetarëve të cilët posedojnë dokumente të vlefshme personale, përfundimisht me datën 24 shkurt të vitit 2013, përbëhet prej 1 743 403 qytetarëve, përkatësisht 77 719 qytetarë më pak sesa në vitin 2011.[18] Përmes televizionit nacional shtetëror KSHZ zhvilloi fushatë me të cilën i informoi qytetarët, të cilët nuk posedojnë dokumente të vlefshme personale, se pa këto dokumente nuk do të mund të votojnë.

Gjithashtu, me qëllim që të inkorporohen rekomandimet e OSBE-së në Kodin Zgjedhor, në muajin prill të vitit 2012, në koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë u formua Grup Punues për amendimin e legjislacionit zgjedhor, më saktë të Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për financimin e partive politike. Grupi Punues, i cili përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Sekretariatit për Çështje Evropiane, Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Entit Shtetëror për Revizion, Këshillit për Radiodifuzion, Delegacionit të Bashkimit Evropian, Ambasadës së SHBA-ve, Misionit të OSBE-së në Shkup, Asociacionit "MOST", grupeve parlamentare: LSDM, VMRO-DPME, BDI, RDK dhe PAE/Liga e Sanxhakut, dhe një eksperte vendore Gordana Siljanovska Davkova, i përgatiti ndryshimet e këtyre dy ligjeve të cilët u miratuan në nëntor të vitit 2012. Ndryshimet përfshijnë një pjesë por jo edhe të gjitha 28 rekomandimet e Raportit të OSBE/ODIHR nga viti 2011.[19] Para së gjithash, me ndryshimet u inkorporuan dispozita në drejtim të

[17] *"LDSM i prezantoi kandidatët për kryetarë të komunave në kryeqytet". "Telma",* 26 tetor, 2012.

[18] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Informatë në lidhje me mbylljen e Listës së Zgjedhësve. E arritshme më 25 shkurt të vitit 2013. <http://www.sec.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=92>

[19] OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights, *The former Yugoslav Republic of Macedonia Early Parliamentary Elections* 5 June 2011. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, October 2011.

kufizimit të funksionarëve aktual nga mundësitë që i kanë në dispozicion kur janë në funksione ekzekutive,[20] precizimit të disa dispozitave të cilat ishin të dykuptimshme, mekanizmave me të cilët rritet sanksionimi dhe kontrolli mbi financimin e fushatës zgjedhore, afateve të qarta sa u përket kundërshtimeve dhe ankesave, rregullimit të së drejtës zgjedhore të personave me nevoja të veçanta dhe të atyre të cilët e vuajnë masën e arrestit shtëpiak dhe harmonizimit me Ligjin për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë. Përveç kësaj, Ligji për financimin e partive politike u amendua, kështu që inkorporoi obligime të detyrueshme për partitë politike që ta publikojnë regjistrin e donacioneve në ueb faqen e tyre deri më 30 prill çdo vit, u inkorporua suspensioni i mjeteve të cilat partisë i akordohen nga Buxheti i RM-së, nëse në afat të rregullt nuk paraqet Raport pranë Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR), si dhe rol më i madh i ESHR-së në këtë sistem të kontrollit dhe humbjen e financimit të rregullt, në afat prej tre muajsh, nëse partia nuk e publikon Raportin.

Këto ndryshime u miratuan pa prezencën e opozitës, e cila e bojkotoi votimin, për shkak të pakënaqësisë që propozimet e saj nuk u inkorporuan.[21]

Në vazhdim prezantohen të gjitha 28 rekomandimet të cilat OSBE/ODIHR i sugjeron pas zgjedhjeve të vitit 2011 me sqarim se a janë implementuar në Kodin Zgjedhor.

A. REKOMANDIME PRIORITARE[22]

1. Organet e pushtetit duhet ta shqyrtojnë mundësinë për zhvillimin e mekanizmave mbrojtës të cilët do të sigurojnë ndarje të mjaftueshme të shtetit nga partia, siç e përcakton paragrafi 5.4 nga Dokumenti i Kopenhagës i OSBE-së nga viti 1990. Mekanizmat ekzistues ligjor të mbrojtjes, siç është Neni 9 nga Kodi Zgjedhor, duhet të interpretohen në mënyrë me të cilën do të pengohet konflikti i interesit inherent, i cili paraqitet në mesin e pozitave ekzekutive të pushtetit, për çka nevojitet pavarësi dhe pozitat për t'u bërë kandidat, të cilat synojnë kah realizimi i përfitimeve politike. Dispozitat e këtilla, po ashtu, mund të ndryshohen dhe plotësohen dhe të përfshijnë mekanizma ekzekutiv.

- Pjesërisht i plotësuar. Neni 8 nga Kodi Zgjedhor është plotësuar dhe precizuar në drejtim të asaj se ushtruesit e funksioneve politike (anëtar i Qeverisë, zëvendësministër, deputet, anëtar i këshillit, kryetar komune) nga dita kur do të përcaktohen si kandidatë për zgjedhje, funksionin e tyre e ushtrojnë në mënyrë teknike dhe ndërmarrin vetëm aktivitete të domosdoshme. Në vazhdim përkufizohet se çka janë aktivitete të domosdoshme të cilat nuk mund të kryhen, mirëpo nuk përkufizohet nocioni teknik. Gjithashtu, nuk parashikohen sanksione për shkelësit. Neni 5.4 nga Dokumenti i Kopenhagës i OSBE-së nga viti 1990 përkufizon "ndarje të qartë të shtetit nga partitë politike; sidomos partitë politike nuk duhet të bashkohen me shtetin" për çka nevojiten masa plotësuese.

2. Duhet të shqyrtohet mundësia për përballjen me të gjitha mangësitë dhe dykuptimësitë e Kodit Zgjedhor të cilat u identifikuan gjatë procesit zgjedhor, duke i përfshirë edhe ato që në mënyrë të veçantë janë theksuar në këto rekomandime. Për këtë qëllim, duhet të zbatohet një proces gjithëpërfshirës konsultimesh, një kohë paraprakisht të mjaftueshme, pas mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme.

- I filluar, por i papërfunduar.

3. Para një kohe relativisht të gjatë duhej të bëhej revizion dhe korrigjim i plotë i Listës Zgjedhore. Kjo duhej të bëhej pas zbatimit të regjistrimit në muajin tetor të viti 2011. Revizioni dhe korrigjimi duhej të fokusoheshin

[20] Hollësisht e shpjeguar në pjesën - *Kufizime për funksionarët aktual.*
[21] Fidanoski, Z. *"Kodi Zgjedhor u miratua pa opozitën". TV "Alfa",* 9 nëntor, 2012.
[22] OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights, *The former Yugoslav Republic of Macedonia Early Parliamentary Elections 5 June 2011.* OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, October 2011,20-23.

mbi pikat e listës, të cilat kanë të bëjnë me personat që kanë ndërruar jetë dhe qytetarët të cilët qëndrojnë jashtë vendit.

- I plotësuar.

4. Akuzat për frikësimin e zgjedhësve, në afat sa më të shkurtër të mundshëm, duhet tërësisht dhe në mënyrë efektive të hulumtohet nga organet e pushtetit, ndërkaq ata që do të zbulohen se janë përgjegjës për këtë, të akuzohen. Qytetarët duhet të inkurajohen dhe t'i denoncojnë akuzat e këtilla përmes paraqitjes së provave të cilat mund të verifikohen.

- Nuk është plotësuar.

5. Duhet të ndërmerren hapa për zgjidhjen e konflikteve të interesit në lidhje me kontrollin mbi radiodifuzerët privat nga ana e personave të cilët janë përfshirë në politikë. Kjo praktikë është në kundërshtim me ligjin dhe e rrënon informimin e balancuar politik gjatë fushatës zgjedhore.

- Në vitin 2012 Këshilli i Radiodifuzionit iu qas implementimit të nenit 11 të Ligjit për veprimtari radiodifuzive, sipas së cilit bartësit e funksioneve publike dhe anëtarët e familjeve të tyre të kenë pjesë në strukturën pronësore ose në themelimin e subjektit radiodifuziv. Radiodifuzerët privat kishin afat, deri më 30 shtator të vitit 2012, për ta harmonizuar strukturën pronësore. Si rezultat i kësaj mase, deputeti Lubisav Ivanov-Xingo djali i të cilit ishte pronar ti Televizionit "Sitel" dha dorëheqje nga funksioni i deputetit,[23] ndërsa Televizioni "Kanal 5" i cili ishte në pronësi të djalit të deputetit Borisllav Stojmenov u shit.[24] Hulumtimet plotësuese dhe monitorimi janë të domosdoshëm që të konstatohet nëse "persona të cilët janë të përfshirë në politikë" ushtrojnë kontroll mbi radiodifuzerët privat.

[23] Kazinovska, S. "Pas 'Sitel'-it edhe 'Kanal 5' kërkon çare". "Dnevnik", 25 shtator, 2012.
[24] "Kanal 5 iu shit Vanja Gavrillovki-t – njeri i afërt i Stojmenov-it?", Portali "Bukvar", 28 shtator 2012.

6. Duhet të inkorporohen afate më të shkurtër për marrjen e vendimeve gjyqësore sipas kundërshtimeve të paraqitura nga ana e Këshillit të Radiodifuzionit, kundër radiodifuzerëve, gjatë fushatës zgjedhore dhe periudhës parazgjedhore. Me këtë do të sigurohet mundësia që Këshilli i Radiodifuzionit t'i implementojë me kohë aktet normative dhe t'u jap mundësi radiodifuzerëve në mënyrë të shpejtë dhe efikase të sigurojnë instrumente juridike në rastet kur u cenohen të drejtat.

- I plotësuar.

B. REKOMANDIME PLOTËSUESE

Korniza ligjore

7. Organet e pushtetit duhet ta revidojnë sistemin ekzistues të shpërndarjes së mandateve në njësitë zgjedhore jashtë vendit, që të garantohet siguri se votat e nevojshme nga diaspora për zgjedhjen e deputetëve në Kuvend, në masë të konsiderueshme nuk do ta nënçmojnë të drejtën e barabartë zgjedhore, e cila garantohet me Kushtetutë dhe me Kodin Zgjedhor.

- Nuk është plotësuar.

8. Duhet të sigurohet e drejta zgjedhore e anëtarëve të këshillave zgjedhorë jashtë vendit dhe e qytetarëve të cilët janë evidentuar se qëndrojnë jashtë vendit më pak se tre muaj.

- Nuk është plotësuar.

9. Kodi Zgjedhor në mënyrë të qartë duhet të përcaktojë se të drejtat zgjedhore të personave të dënuar me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej më shumë se gjashtë muaj, u mundësohen përsëri pas vuajtjes së dënimit të këtillë.

- Nuk është plotësuar.

Administrata zgjedhore

10. Përfitim i madh, sa i përket zbatimit të suksesshëm të zgjedhjeve të ardhshme, mund të arrihet përmes miratimit me kohë të akteve normative gjithëpërfshirëse të cilat do t'i përcaktojnë udhëzimet e procesit zgjedhor dhe do t'i kompensojnë mangësitë apo jokonsekuencat e Kodit Zgjedhor.

- Pjesërisht i plotësuar. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar disa udhëzime me të cilat jepen orientime në lidhje me procesin zgjedhor, por akoma ekzistojnë paqartësi në Kodin Zgjedhor.

11. Në mënyrë që të përmirësohet transparenca, procesverbalet nga mbledhjet e KSHZ-së mund të jenë të arritshëm për publikun.

- I plotësuar. Është inkorporuar si detyrim ligjor dhe zbatohet nga ana e KSHZ-së. (Neni 43-b)

Regjistrimi i zgjedhësve

12. Informatat të cilat i përshkruajnë procedurat për regjistrimin në Listën e Zgjedhësve të qytetarëve, të cilët qëndrojnë jashtë vendit, duhet të publikohen në vendet e huaja, një kohë të mjaftueshme paraprakisht, para mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme.

- Nuk është plotësuar.

Fushata zgjedhore

13. Aktet normative për fushatën zgjedhore duhet të respektohen dhe implementohen tërësisht. Organet e pushtetit mund ta shqyrtojnë mundësinë për ndryshimin e akteve normative për të cilat shumica e partive konsiderojnë se janë tepër restriktive, si ato për kufizimin e periudhës së fushatës zgjedhore, ato të cilat i përcaktojnë aktivitetet e fushatës zgjedhore dhe ato të cilat e përcaktojnë afishimin e pllakateve.

- Nuk është plotësuar.

14. Fushata për edukimin e zgjedhësve, pavarësisht nëse i zbatojnë organet e pushtetit, organizatat civile ose partitë politike, duhet të fokusohen mbi fshehtësinë e votimit, që paraqet instrument kryesor për luftë kundër frikësimit ose shfrytëzimit të presionit që të ndikohet mbi lirinë e zgjedhjes së votuesit. Zgjedhësit duhet të inkurajohen që ata të insistojnë që t'u respektohet fshehtësia e votës.

- Rekomandimi ka të bëjë për kohën e fushatës zgjedhore.

Financimi i fushatës zgjedhore

15. Dispozitat për njoftim financiar të fushatës zgjedhore duhet të zgjerohen në mënyrë që të përcaktohen mekanizma më efikas për revizion.

- Nuk është plotësuar.

Gjithashtu, duhet të shqyrtohet mundësia e miratimit të formularit më të detajuar për njoftimin financiar, me ç'rast organizatorët do të detyrohen që në fushata zgjedhore t'i publikojnë shpenzimet sipas zërave të veçantë.

- Nuk është plotësuar. Formuar i ri i detajuar për raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve për fushatën zgjedhore, pas atij të miratuar në vitin 2011, nuk është miratuar.[25]

16. Duhet të inkorporohen afate për revizionin e raporteve financiare para ditës së zgjedhjeve.

- Nuk është plotësuar.

Institucionet kompetente duhet t'i përforcojnë resurset e tyre që të mundësojnë revizion të përpiktë dhe me kohë të raporteve financiare.

- Nuk është plotësuar.

[25] Ministria e Financave 25 maj 2011. Formulari "Raport financiar për të ardhurat dhe shpenzimet e xhiro-llogarisë për fushatën zgjedhore ". I arritshëm më datë 25.02.2013 http://www.finance.gov.mk/node/1961

17. Dallimet, sa i përket llojit të shumave maksimale të donacioneve për fushatën zgjedhore për individ dhe persona juridikë, duhet të ndryshohen. Dispozitat ekzistuese janë diskriminuese dhe në mënyrë të padrejtë u japin përparësi subjekteve më të mëdha.

- Nuk është plotësuar.

Mediat

18. Gjatë caktimit të anëtarëve të Këshillit të Radiodifuzionit prioritet duhet t'i jepet profesionalizmit dhe paanshmërisë të kandidatëve për anëtar, në vend të lidhjes politike të anëtarëve të këtillë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme meqë me ndryshimet e Ligjit për veprimtari radiodifuzive, të miratuara më 18 korrik, numri i anëtarëve të këtij organi u rrit nga 9 në 15.

- Në mënyrë plotësuese duhet të monitorohet puna e Këshillit të Radiodifuzionit.

19. Me qëllim që ta ruaj pavarësinë e vet, Këshillit të Radiodifuzionit i nevojitet mbështetje financiare përkatëse dhe me dedikim.

- Nuk është plotësuar.

20. Mund të përfshihen rregulla të detajuara për prezantimin e fushatës zgjedhore në mediat në Ligjin për veprimtari radiodifuzive dhe Kodin Zgjedhor, në vend që të njëjtat të miratohen veç e veç për çdo zgjedhje.

- Nuk është plotësuar.

21. Pavarësia e radiodifuzerit publik mund të përforcohet nëse sigurohet financimi i tij përkatës.

- Nuk është plotësuar.

Pjesëmarrja e femrave

22. Organet e pushtetit duhet t'i përkushtojnë një vëmendje më të madhe praktikës së votimit familjar, i cili është veçanërisht i pranishëm tek bashkësitë më të vogla etnike. Organet e pushtetit duhet t'i hulumtojnë mënyrat e eliminimit të kësaj praktike dhe të angazhohen për zbatimin konsekuent të nenit 112 të Kodit Zgjedhor.

- Në ditën e zgjedhjeve është i domosdoshëm monitorimi.

Vëzhgimi i zgjedhjeve

23. Kodi Zgjedhor ose aktet normative zgjedhore në mënyrë të qartë duhet të përcaktojnë se vëzhguesit vendas dhe të huaj kanë të drejtë të pranojnë kopje nga të gjitha procesverbalet e rezultateve nga këshillat zgjedhorë dhe nga komisionet komunale të zgjedhjeve dhe jo vetëm kopje nga pjesa që ka të bëjë me rezultatet e sublimuara.

- Është plotësuar. Është inkorporuar ndryshimi në nenet 118, 126 dhe 131.

24. KSHZ dhe komisionet komunale të zgjedhjeve duhet ta sigurojnë zbatimin e kushtit për publikimin e kopjeve të procesverbaleve të rezultateve të këshillave zgjedhorë, menjëherë pas përfundimit të numërimit të votave.

- Në ditën e zgjedhjeve duhet të monitorohet.

Kundërshtime dhe ankesa

25. Procedurat e kundërshtimeve dhe ankesave duhet të thjeshtëzohen dhe të publikohen kudo. KSHZ duhet të miratojë procedura të detajuara për mënyrën e paraqitjes dhe vendimmarrjes sipas kundërshtimeve me qëllim që të sigurojë zbatim konsekuent dhe efikas të Kodit Zgjedhor.

- Nuk është plotësuar.

26. Duhet të shqyrtohet mundësia e shlyerjes së kufizimit nga neni 73 të Kodit Zgjedhor i cili ua kufizon të drejtat kandidatëve që zgjidhen të mund të kundërshtojnë vetëm ndaj veprimeve të ndërmarra nga ana e kundër-kandidatëve.

- Nuk është plotësuar.

27. Neni 31 (2) (35) nga Kodi Zgjedhor, i cili e autorizon KSHZ të bëjë këqyrje në materialin zgjedhor sipas kundërshtimeve të paraqitura, por nëse ka së paku dy kundërshtime të këtilla për vendin përkatës zgjedhor, duhet të shlyhet meqë e rrënon të drejtën e instrumentit efikas juridik. Nuk duhet të ekzistojë kusht për numrin e kundërshtimeve të paraqitura para se të njëjtit të shqyrtohen.

- Nuk është plotësuar.

28. Neni 105 nga Kodi Zgjedhor duhet të jetë më i përpiktë me qëllim që në mënyrë të qartë të përcaktojë nëse ekziston ose nuk ekziston kusht gjatë paraqitjes së kundërshtimit në KSHZ në ditën e zgjedhjeve, ky kundërshtim fillimisht të regjistrohet në procesverbalin e Këshillit Zgjedhor (KZ) përkatës ose në Komisionin Komunal përkatës të Zgjedhjeve (KKZ).

- Nuk është plotësuar.

Duke e pasur parasysh se ndryshimet e legjislacionit zgjedhor nuk i përfshijnë të gjitha fushat problematike Grupi Punues pranë Ministrisë së Drejtësisë do të vazhdojë me punë në lidhje me rekomandimet e tjera.

HISTORIKU I ZGJEDHJEVE LOKALE NË MAQEDONI

Zgjedhjet e para lokale në Republikën e pavarur të Maqedonisë u mbajtën **në vitin 1996**, me ç'rast jehona mesatare e votuesve për zgjedhjen e këshilltarëve të komunave ishte 60.17%, ndërsa për Qytetin e Shkupit 53.20%. Jehona mesatare e votuesve për zgjedhjen e kryetarit të komunave ishte 60.28%, ndërsa për Qytetin e Shkupit 53.20%. Në këto zgjedhje ndodhi anulimi i votimit në disa komuna të caktuara, kështu që këto të dhëna nuk i përshijnë rezultatet e zgjedhjes së kryetarëve të komunave ose anëtarëve të këshillave në gjithsej 9 komuna. Këto zgjedhje lokale u zhvilluan sipas organizmit territorial nga vitit 1996, sipas së cilit u formuan 123 komuna dhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë.[26] Së këtejmi, LSDM e fitoi numrin më të madh të vendeve të kryetarëve të komunave 51, VMRO-DPMNE dhe MAAK-Konservative 27, ndërsa Partia Socialiste 19.[27] Në këto zgjedhje të drejtë vote kishin 1 495 288 zgjedhës.

Në **zgjedhjet lokale të vitit 2000** u vërejt një numër i konsiderueshëm i shkeljeve të procesit zgjedhor dhe të standardeve ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe demokratike. Në këto zgjedhje u vërejt një numër i madh incidentesh, dhunë dhe frikësim të votuesve. Në disa komuna: Gostivar, Tetovë, Llabunishtë, Xhepçishtë dhe Hanet e Mavrovës, gjatë zgjedhjeve ka pasur edhe incidente të armatosura. Në disa vende zgjedhore, në komuna të tjera, kutitë e votimit janë hapur me dhunë dhe janë shkatërruar. Dhuna u përsërit në vende të ndryshme edhe gjatë rrethit të dytë të votimit. Misioni i OSBE/ODIHR ka reaguar për votim grupor në 25% të vendeve që i ka vëzhguar, në 8% ka vërejtur votim të hapur dhe në 5% votim në emër të tjetrit. Pas këtyre zgjedhjeve, KSHZ nuk publikoi rezultate gjithëpërfshirëse dhe të plota për zgjedhjet. Në rrethin e parë, Koalicioni "Bashkë për Maqedoninë", i udhëhequr nga LSDM, fitoi 38% të votave për kryetarë të komunave, Koalicioni i VMRO-DPMNE dhe Alternativa Demokratike (AD) 27%, PDSH 13%, ndërkaq PPD 6%.[28] Rezultatet finale rezultuan me fitore të Koalicionit të VMRO-DPMNE dhe Alternativës Demokratike "Për ndryshime" në 48% të komunave, përkatësisht ata fituan 59 vende të kryetarëve të komunave, ndërsa Koalicioni i udhëhequr nga LSDM "Bashkë për Maqedoninë" fitoi 32 vende

[26] *Ligji për ndarje territoriale të Republikës së Maqedonisë dhe përcaktimin e rajoneve të njësive të vetëqeverisjes lokale. "Gazeta Zyrtare e RM"-së,* 49 nga 14.09.1996.

[27] MOST Asociacioni Qytetar. Raporti final, Vëzhgimi vendas i Zgjedhjeve Presidenciale dhe Lokale 2009. Shkup, 2009.

[28] OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights. *Former Yugoslav Republic of Macedonia Municipal Elections* 10 September 2000. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, 2000

të kryetarëve të komunave.[29] Në këto zgjedhje, të drejtë vote kishin 1 634 859 zgjedhës.

Zgjedhjet lokale të vitit 2005 sërish nuk i plotësuan standardet kryesore ndërkombëtare për universalizëm, barazi dhe fshehtësi të së drejtës së votës. Për dallim nga zgjedhjet paraprake, në këto zgjedhje nuk pati dhunë, por u vërejt një numër i madh parregullsish në pjesën perëndimore, veriperëndimore të vendit dhe në Shkup. Njëherësh, zgjedhjet e vitit 2005 janë zgjedhjet e para që u zbatuan sipas organizimit territorial të vitit 2004, sipas së cilit u formuan 84 komuna në territorin e Maqedonisë dhe u ruajt statusi i Qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale.[30] Nga Misioni i OSBE/ODIHR u vërejtën 30 raste të mbushjes së kutive të votimit dhe mbi 50 raste të votimit në emër të tjetrit. Në 9 komuna, në mesin e të cilave edhe Qyteti i Shkupit, si rezultat i ankesave të cilat kishin të bënin me parregullsi të votimit në rrethin e parë, i njëjti u desh të përsëritet. Në këto vende, po ashtu, duhej të zbatohej edhe rrethi i dytë i votimit, që rezultoi me rreth të dytë të vonuar, i cili u mbajt më 10 prill të vitit 2005. Jehona e votuesve në rrethin e parë ishte 56.36%, në rrethin e dytë më 27 mars ishte 53.66%, ndërsa më 10 prill ishte 35.6%. Në këto zgjedhje fitoi Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, i cili fitoi 36 vende të kryetarëve të komunave. VMRO-DPMNE dhe Koalicioni fituan 21 vende të kryetarëve të komunave, BDI 15, VMRO-PP 3, PDSH 2 dhe Lidhja e Romëve 1. Shtatë kandidatë të pavarur u bënë kryetarë të komunave, në mesin e të cilëve edhe kandidati për Qytetin e Shkupit Trifun Kostovski, i cili u mbështet nga VMRO-DPMNE.[31] Në këto zgjedhje të drejtë vote kishin 1 711 293 zgjedhës.

Zgjedhjet lokale të vitit 2009, të cilat u mbajtën në ditën e njëjtë me zgjedhjet presidenciale, janë zgjedhjet e para lokale që u zhvilluan në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare dhe standardet e OSBE-së për zgjedhje demokratike. Mirëpo edhe për këto zgjedhje Misioni i OSBE/ODIHR kishte vërejtje të mëdha në lidhje me frikësimin e votuesve. Raporti vëzhgues flet për frikësimin dhe presionet ndaj votuesve, veçanërisht mbi të punësuarit në administratën publike dhe ndaj shfrytëzuesve të ndihmës sociale, të cilët kanë qenë nën kërcënime që të votojnë për partinë në pushtet.[32] Edhe në zgjedhjet e vitit 2009 është vërejtur votimi familjar, votimi në emër të tjetrit (në 3% të rasteve), një person i njëjtë t'u "ndihmojë" më shumë votuesve (4%), tentativë që të ndikohet mbi votuesit (4%), frikësim i votuesve dhe anëtarëve të këshillave zgjedhorë (KZ) (1%), nënshkrime identike në ekstraktin e Listës së Zgjedhësve (2%) dhe votime të shumëhershme (1%).[33] VMRO-DPMNE ishte fitues në 56 komuna, BDI në 15, LDM në 7, ndërkaq PDSH, DR, PDTM, LR, PSDM fituan nga një kryetar komune. Dy kandidatë të pavarur fituan vende të kryetarëve të komunave. Në këto zgjedhje të drejtë vote kishin 1 792 082 zgjedhës.

Në këtë kontekst rekomandimet prioritare nga viti 2009, të cilat përsëriten në Raportin për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011, kërkojnë nga Qeveria të ndërmarr masa dhe të përballet me presionet dhe frikësimet ndaj votuesve. Përveç kësaj, Raporti i ODIHR/OSBE sugjeroi edhe pesë rekomandime të tjera prioritare: të ndahet shteti nga partia; të korrigjohen të gjitha mangësitë dhe dykuptimësitë në Kodin Zgjedhor; rishikim dhe korrigjim të Listës së Zgjedhësve; të ndërmerren masa me të cilat do të zgjidhen konfliktet e interesit ndërmjet personave të përfshirë në politikë, ndërkaq të cilët ushtrojnë kontroll mbi radiodifuzerët privat dhe përcaktimin e afateve brenda të cilëve gjykata duhet të merr vendime sa u përket kundërshtimeve të Këshillit të Radiodifuzionit. Në të dy raportet OSBE/ODIHR apelojnë për rishikimin e Listës së Zgjedhësve, që është njëri nga rekomandimet e përmbushur. Bashkimi Evropian konsideron se Republika e Maqedonisë ka arritur progres në zbatimin e zgjedhjeve dhe i përsëritë konkluzionet dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR. Ambasadori i

[29] MOST Asociacioni Qytetar. *Raporti final, Vëzhgimi vendas i Zgjedhjeve Presidenciale dhe Lokale 2009. Shkup, 2009.*

[30] *Ligji për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale.* "Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 55/2004 nga 16.08.2004.

[31] *MOST Asociacioni Qytetar. Raporti final, Vëzhgimi vendas i Zgjedhjeve Presidenciale dhe Lokale 2009. Shkup, 2009.*

[32] OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights, *The former Yugoslav Republic of Macedonia Presidential and Municipal Elections* 22 March and 5 April 2009. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, June 2009

[33] Ibid.

atëhershëm i SHBA-ve, Filip Riker i vlerësoi zgjedhjet si mirë të realizuara.[34]

Tabela 1: Jehona e zgjedhjeve lokale nga viti 1996 deri në vitin 2009,[35] për rrethin e parë dhe të dytë[36]

Viti	**1996**	**2000**	**2005**	**2009**
Jehona	60%(51%)	59% (53%)	56%(53%)	57% (43%)

[34] Popovski, R. *Interview with Philip T. Reeker, U.S. Ambassador to the Republic of Macedonia. X/0 talks show, Kanal 5 TV.* 8 qershor 2011.

[35] OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights, Former Yugoslav Republic of Macedonia Municipal Elections 10 September 2000. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, 2000; OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights, The former Yugoslav Republic of Macedonia, Municipal Elections 13 and 27 March, and 10 April 2005. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, June 8, 2005; OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights, The former Yugoslav Republic of Macedonia Presidential and Municipal Elections 22 March and 5 April 2009. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, June 2009.

[36] Përqindja e parë ka të bëjë me jehonën në rrethin e parë, ndërkaq përqindja e dytë jehona me jehonën në rrethin e dytë. Përqindjet janë rrumbullakuar.

SISTEMI ZGJEDHOR MAQEDONAS I ZGJEDHJEVE LOKALE

SISTEMI ZGJEDHOR MAQEDONAS I ZGJEDHJEVE LOKALE[37]

MODELI ZGJEDHOR

Në Republikën e Maqedonisë, zgjedhjet për **kryetarë të komunave** në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) zbatohen sipas modelit zgjedhor të shumicës, ndërsa zgjedhjet për **anëtarë të këshillave në njësitë e vetëqeverisjes lokale** sipas modelit proporcional. Zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe për anëtarë të këshillave mbahen, në **çdo katër vjet,** njëkohësisht në të gjitha komunat, në gjysmën e dytë të muajit mars. Kryetari i Kuvendit zgjedhjet i shpall me akt përkatës, i cili publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", me ç'rast nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në mbajtjen e zgjedhjeve nuk mund të kalojnë më shumë se 90 ditë, përkatësisht më pak se 70 ditë.

Zgjedhja e kryetarit të komunës në njësitë e vetëqeverisjes lokale zbatohet sipas **modelit zgjedhor të shumicës**. Për kryetar komune është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicë votash në rrethin e parë të votimit, nëse në zgjedhje kanë dal së paku një e treta e zgjedhësve të regjistruar në Listën e Zgjedhësve të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes lokale. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk e plotëson kushtin e nevojshëm, zgjedhjet përsëriten në rrethin e dytë për ata dy kandidatë të cilët kanë fituar numër më të madh të votave. Nëse në zgjedhje merr pjesë vetëm një kandidat, ndërkaq i njëjti nuk e fiton shumicën e nevojshme, procedura zgjedhore përsëritet. Rrethi i dytë i votimit zbatohet 14 ditë pas përfundimit të rrethit të parë. Në rrethin e dytë zgjidhet ai kandidat i cili ka fituar numër më të madh të votave.

[37] Sipas Kodit Zgjedhor (teksti i spastruar). *"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë"* nr. 54 nga data 14.04.2011 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor *"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë"* nr. 142 nga data 13.11.2012.

Gjatë **zgjedhjes së këshilltarëve** në NJVL zbatohet **modeli proporcional**, me ç'rast shpërndarja e mandateve bëhet sipas formulës së D'Hondt-it. Sipas kësaj formule, numri i përgjithshëm i votave të fituara për listat e propozuara të kandidatëve pjesëtohet me vargun e përpjesëtuesve 1,2,3... kështu deri në numrin e anëtarëve të këshillit të cilët zgjidhen në NJVL konkrete. Herësit e fituar në këtë mënyrë radhiten sipas madhësisë, me ç'rast merren parasysh ata herës më të mëdhenj aq sa zgjidhen anëtarë të këshillit. Një listë e kandidatëve fiton aq anëtarë të këshillit sa ka herës më të mëdhenj prej atyre që janë marrë parasysh.

ORGANE PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

Organe të cilat i zbatojnë zgjedhjet janë: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, këshillat zgjedhorë (KZ), si dhe këshillat zgjedhorë në përfaqësitë diplomatike-konsullore. KSHZ është organi kryesor përgjegjës për zbatimin e zgjedhjeve. Komisionet komunale të zgjedhjeve dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit janë përgjegjëse për njësi të caktuara të vetëqeverisjes lokale, ndërkaq këshillat zgjedhorë janë përgjegjës për zbatimin e zgjedhjeve në vendet zgjedhore. Përbërjen e KSHZ-së (kryetarin, nënkryetarin dhe pesë anëtarët) i zgjedh Kuvendi, 60 ditë pas seancës konstituive të Kuvendit për periudhën e mandatit katërvjeçar. Kodi Zgjedhor parashikon që zgjedhja e anëtarëve të KSHZ të bëhet sipas propozimit të partive politike, me ç'rast partitë opozitare e propozojnë kryetarin dhe dy anëtarë, ndërkaq partitë në pushtet e propozojnë nënkryetarin dhe tre anëtarë. Nëse partitë politike nuk paraqesin propozim në Kuvend për kryetar, nënkryetar dhe anëtarë të KSHZ-së, atëherë propozim paraqet Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve pranë Kuvendit. Partitë kanë afat prej tre ditësh, pas njoftimit të Kryetarit të Kuvendit, t'i paraqesin propozimet e tyre.

KSHZ është përgjegjëse për **mbajtjen e Listës së Zgjedhësve** në të cilën regjistrohen të gjithë qytetarët që kanë mbushur moshën 18 vjeçare, të cilët kanë vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë, duke i përfshirë edhe ata të cilët janë me qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, të cilët kanë letërnjoftim të vlefshëm ose dokument të vlefshëm udhëtimi. Në Listën e Zgjedhësve nuk regjistrohen ata qytetarë të cilët e kanë humbur aftësinë e punës me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Komisionet komunale të zgjedhjeve, përbëhen nga kryetari dhe katër anëtar (si dhe nga zëvendësit e tyre), zgjidhen me zgjedhje të rastësishme nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore dhe komunale, të cilët kanë kryer arsim të lartë. Mandati i tyre është 5 vjeçar, ndërkaq zgjedhjen e bën KSHZ. Përbërja e **këshillave zgjedhorë** paraqet një kombinim të të punësuarve në administratën shtetërore dhe komunale (kryetari, zëvendëskryetari, dy anëtarë dhe zëvendës të tyre), si dhe përfaqësues të partive politike. Një anëtar dhe zëvendësin e tij e propozojnë partitë opozitare, të cilat kanë fituar më së shumti vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. Gjithashtu, nga një anëtar dhe zëvendës të tyre propozojnë partitë që e kanë fituar pushtetin në zgjedhjet e fundit parlamentare. Mandati i anëtarëve të këshillave zgjedhorë është 4 vjeçar. Zgjedhjen e rastësishme të anëtarëve të këshillave zgjedhorë (nga radhët e administratës) e bën KKZ dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit për rajonin për të cilin janë përgjegjës, sipas aktit paraprak të KSHZ-së.

Në ato komuna, në të cilat jetojnë më së paku 20% të qytetarëve që u takojnë bashkësive jo shumicë, zbatohet principi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat gjatë përbërjes së KKZ-së dhe këshillave zgjedhorë. Ligji parashikon përfaqësim prej më së paku 30% të çdo gjinie në përbërjen e organeve zgjedhore.

Anëtarët e KKZ-së dhe të këshillave zgjedhorë nuk mund të jenë funksionarë të zgjedhur ose të emëruar nga Qeveria, Kuvendi dhe persona të punësuar në administratën shtetërore të Avokatit të Popullit, Ministrisë së Drejtësisë, Mbrojtjes, Punëve të Brendshme, Sekretariatit Ligjvënës, Entit Shtetëror të Statistikës, Qendrës për Menaxhim me Kriza, shërbimet profesionale të Gjykatës Administrative, KSHZ-së dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).

Organet zgjedhore punojnë dhe marrin vendime nëse në mbledhjet e tyre merr pjesë shumica e anëtarëve. Në rast të mungesës së anëtarit të KKZ-së, Komisionit Zgjedhor të Qytetit të Shkupit dhe Këshillit Zgjedhor, në punime marrin pjesë zëvendësit e atyre anëtarëve, po ashtu të zgjedhur nga KSHZ. Vendimet në të gjitha organet zgjedhore merren me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

E DREJTA PËR T'U ZGJEDHUR

Kandidat për kryetar të komunës ose për anëtar të këshillit mund të jetë personi i cili ka mbushur moshën18 vjeçare dhe është i aftë për punë. Personi i cili është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, me dënim pa kusht me burgim prej mbi 6 muajsh, vuajtja e të cilit nuk ka filluar, ose gjendet në vuajtje të dënimit për vepër të kryer penale, nuk mund të jetë kandidat për këto pozita. Përveç këtyre kushteve, kandidati për kryetar komune ose për anëtar të këshillit duhet të ketë vendbanim të përhershëm në NJVL në të cilën kandidohet.

Me Ligjin për përcaktimin kushtit plotësues për kryerje të funksionit publik (i njohur si Ligji për lustrim) në vitin 2008 u inkorporua kushti plotësues i të drejtës për t'u zgjedhur. U përcaktua që kryetarët e komunave dhe kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit, si dhe anëtarët e këshillave të mos mund ta kryejnë këtë funksion, nëse konstatohet se janë evidentuar në dosjet e organeve shtetërore si bashkëpunëtorë dhe informatorë sekret gjatë grumbullimit të informatave dhe të dhënave me të cilat janë shkelur liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve për motive politike ose ideologjike. Çdo kandidat për kryetar komune ose për këshilltar e plotëson kushtin plotësues atëherë kur Komisioni për Verifikimin e Fakteve do ta verifikojë deklaratën e tij/saj me shkrim për mosbashkëpunim me organet e sigurimit shtetëror. Kandidatët paraqesin deklaratë me shkrim për mosbashkëpunim dhe njëkohësisht me dhënien e pëlqimit të tij personal për kandidaturën, ndërkaq në rast të mosparaqitjes, organet zgjedhore ndaj këtij akti veprojnë si ndaj një parregullshmërie

në procedurën zgjedhore. Komisioni menjëherë ngre procedurë për verifikimin e deklaratës së kandidatit dhe më së voni në afat prej 24 orësh nga pranimi i deklaratës. [38]

Vetëm personat të cilët e përmbushin kushtin plotësues kanë të drejtë të jenë kandidatë për kryetarë të komunave ose për këshilltarë.

KUFIZIME PËR FUNKSIONARËT AKTUAL – KANDIDATË PËR KRYETARË TË KOMUNAVE OSE KËSHILLTARË

Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, nga muaji nëntor i vitit 2012, anëtarë të Qeverisë dhe zëvendësministra, nëse kandidohen për kryetarë të komunave ose këshilltarë të këshillave (e njëjta ka të bëjë nëse janë kandidatë për President të Republikës ose për deputetë), janë të kufizuar në kryerjen e aktiviteteve të tyre në kuadër të funksioneve të cilat i kanë. Ushtruesi i këtij funksioni, i cili është kandidat nuk mund të ketë në dispozicion mjete buxhetore të Republikës, të fondeve publike të komunave dhe Qytetit të Shkupit, mjete të ndërmarrjeve publike, institucioneve dhe personave të tjerë juridikë të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror, si dhe të objekteve të tjera të cilat kryejnë veprimtari shoqërore (kopshte të fëmijëve, shkolla, fusha sportive dhe ngjashëm). Këta persona nuk mund të bëjnë pagesa të jashtëzakonshme të pagave, pensioneve, asistencës sociale, si dhe pagesa të tjera me mjete buxhetore ose nga fondet publike. Njëkohësisht, këta persona nuk mund të lidhin marrëveshje për tjetërsimin e kapitalit shtetëror e as të nënshkruajnë marrëveshje kolektive. Këto kufizime aktivizohen nga dita e marrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të zgjedhjeve për kryetarë të komunave dhe këshilltarë, përkatësisht deri në konstituimin e këshillave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit.[39]

[38] *Ligji për përcaktimin e kushtit plotësues për kryerje të funksionit publik. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.* 14 nga 29.01.2008. Shih nenet 2,5,9 dhe 12.

[39] *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor Neni 2. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.* 142 nga data 13.11.2012

NUMRI I ANËTARËVE TË KËSHILLAVE

Numri i anëtarëve të këshillit të çdo njësie të vetëqeverisjes lokale përcaktohet sipas numrit të popullsisë që jeton në kuadër të tyre. Komunat të cilat kanë deri në 5000 banorë formojnë këshilla të përbërë nga 9 anëtarë, komunat të cilat kanë ndërmjet 5001 dhe 10000 – 11 anëtarë, ato komuna që kanë ndërmjet 10001 dhe 20000 – 15 anëtarë, ato që kanë ndërmjet 20001 dhe 40000 – 19 anëtarë, ndërmjet 40001 dhe 60000 – 23 anëtarë, prej 60001 dhe 80000 – 27 anëtarë, ndërmjet 80001 dhe 100000 – 31 anëtarë dhe mbi 100000 – 33 anëtarë.[40] Këshillin e Qytetit të Shkupit e përbëjnë 45 anëtarë.

E DREJTA DHE PROCEDURA PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR KRYETARË TË KOMUNAVE DHE LISTAVE PËR KËSHILLTARË

Të drejtë për paraqitjen e listave të kandidatëve për këshilltarë dhe kandidatit për kryetar të komunës kanë partitë e regjistruara politike në mënyrë të pavarur ose në koalicion, si dhe grupe të zgjedhësve. Varësisht nga madhësia e NJVL-së, grupet e zgjedhësve duhet të grumbullojnë numër të caktuar të nënshkrimeve: nga 100 nënshkrime për NJVL-të deri në 10 000 banorë, prej më së paku 450 për NJVL-të me mbi 100 001 banorë, ndërkaq për kandidimin për Qytetin e Shkupit nevojiten 1 000 nënshkrime.

Në kuadër të listës së kandidatëve për këshilltarë, në çdo vend të tretë doemos duhet të nominohet kandidat i cili është pjesëtar i asaj gjinie e cila është më pak e përfaqësuar në listë.

Lista e kandidatëve për anëtar të këshillit dhe për kandidat për kryetar të komunës paraqitet në formular të përcaktuar nga KKZ, më së voni 35 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. KKZ-ja i publikon këto lista më së voni 25 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

40 *Ligji për vetëqeverisje lokale. Neni 34. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.* 5 nga 29.01.2002.

FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata zgjedhore fillon 20 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve dhe mund të zgjas deri 24 orë para fillimit të zgjedhjeve. Fushatë zgjedhore nuk guxon të zhvillohet në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve.

Fushata zgjedhore mund të financohet nga pagesa e anëtarësisë së partive politike, si dhe nga donacione të cilat nuk guxojnë ta tejkalojnë shumën prej 5000 euro për persona fizikë dhe 5% nga të ardhurat e përgjithshme në vitin paraprak për persona juridikë. Fushata mund të financohet me para, sende dhe shërbime. Fushatat zgjedhore nuk mund të financohen nga mjetet e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, mjetet e shoqatave të qytetarëve, komuniteteve fetare, grupeve religjioze dhe fondacioneve, mjetet nga qeveri të huaja dhe institucioneve ndërkombëtare, si dhe mjete të ndërmarrjeve me kapital të përbashkët në të cilat dominon kapitali i huaj por edhe nga burime të paidentifikuara.

Fushatat nuk mund të financohen në mënyrë të drejtpërdrejt nga buxheti shtetëror, e as nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale, por kandidatët e zgjedhur për president, deputetë, kryetar të komunës dhe këshilltarë kanë **të drejtë kompensimi** nga buxheti shtetëror në lartësi prej 15 denarë për votë të fituar nëse kanë fituar së paku 1,5% prej qytetarëve që kanë dal në zgjedhje në nivel qendror, në nivel lokal ose në njësinë zgjedhore. Këto mjete paguhen më së voni deri në tre muaj pas paraqitjes së raportit financiar për fushatën zgjedhore, i cili paraqitet në afat prej 15 ditësh pas përfundimit të së njëjtës. Raporti financiar për fushatën zgjedhore paraqitet në KSHZ, në Entin Shtetëror për Revizion, Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe në Kuvend, ndërkaq në rast të zgjedhjeve lokale edhe në këshillat e NJVL. KSHZ, ESHR dhe KSHPK e kanë për detyrë të lidhin memorandum për bashkëpunim për shkëmbim të informatave, sa u përket parregullsive të konstatuara në lidhje me raportet e paraqitura financiare dhe masave të zbatuara ndaj subjekteve nën monitorim.[41]

41 *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë"* nr. 142 nga data 13.11.2012

ROLI I MJETEVE TË INFORMIMIT PUBLIK

Mediat e kanë për detyrë të mundësojnë **qasje të barabartë për prezantimin e programeve zgjedhore dhe të kandidatëve**. Këshilli i Radiodifuzionit është i angazhuar që të përpilojë Rregullore për sjelljen e radiodifuzerëve në periudhën para fillimit të fushatës dhe Rregullore për qasje të barabartë të prezantimit mediatik gjatë kohës së fushatës. Të gjitha organizatat mediatike, elektronike ose të shtypura, e kanë për detyrë t'i respektojnë këto akte normative. Këshilli i Radiodifuzionit është i angazhuar ta ndjek prezantimin zgjedhor në mjetet e informimit publik, ndërkaq në rast të shkeljes së parimit të qasjes së barabartë e ka për detyrë të hap procedurë për kundërvajtje kundër radiodifuzerit përgjegjës. Këshilli i Radiodifuzionit është po ashtu i angazhuar ta ndjek sjelljen e **servisit publik Radiodifuziv**, i cili mundëson **prezantim falas** të programeve zgjedhore sipas parimit të barabarësisë. Servisi publik, po ashtu e ka për detyrë pa kompensim t'i informojë qytetarët për mënyrën dhe teknikën e votimit, si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

Rezultatet nga anketa e mendimit publik që ka të bëjë me kandidatët nuk guxon të publikohet përmes mjeteve të informimit publik gjatë 5 ditëve të fundit para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Të drejtë vëzhgimi të zgjedhjeve kanë vëzhgues të akredituar, me ç'rast KSHZ e lëshon autorizimin. Akreditim për vëzhgues mund të fitojnë organizata vendase civile të cilat janë regjistruar së paku një vit para mbajtjes së zgjedhjeve, të cilat në statusin e tyre e kanë inkorporuar parimin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Organizatat dhe përfaqësuesit ndërkombëtar të vendeve të tjera, gjithashtu, mund t'i vëzhgojnë zgjedhjet. Përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave kanë të drejtë të përcaktojnë përfaqësuesin e tyre i cili do ta mbikëqyrë punën e organeve zgjedhore.

PARTI DHE KOALICIONE POLITIKE

VMRO - PARTIA DEMOKRATIKE PËR UNITET KOMBËTAR MAQEDONAS (VMRO-DPMNE)

VMRO-DPMNE është parti e cila deklarohet si parti popullore e qendrës së djathtë, me proveniencë ideologjike demokristiane. U themelua më 17 qershor të vitit 1990, me çka angazhim i saj kryesor në atë periudhë ishte ndarja e Maqedonisë nga Federata jugosllave, me qëllim të formimit të shtetit të pavarur dhe autonom të Maqedonisë. Kryetar i partisë, nga themelimi (i cili atëbotë ishte 24 vjeç) e deri në Kongresin partiak në muajin maj të vitit 2003, ishte Lubço Georgievski. Në zgjedhjet e para shumë-partiake parlamentare të cilat u zhvilluan më 11 nëntor 1990, VMRO-DPMNE fitoi më së shumti vota (24.24%), por nuk arriti të sigurojë shumicë absolute në Kuvend.

Nga pavarësimi e deri më sot, VMRO-DPMNE është njëra nga dy partitë më të mëdha në elektoratin etnik maqedonas. Ka marrë pjesë thuajse në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale me përjashtim të zgjedhjeve parlamentare të vitit 1994, kur e bojkotoi rrethin e dytë. Në zgjedhjet e treta parlamentare, të mbajtura në vitin 1998, me 49 mandate të fituara në koalicion me Alternativën Demokratike, e cila fitoi 13 deputetë dhe Partia për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH)-Partia Demokratike Popullore (PDP) (më vonë PDSH) me 11 dhe disa parti të vogla, VMRO-DPMNE për të parën herë formoi Qeveri. VMRO-DPMNE mbetet në pushtet deri në vitin 2002, por gjatë kohës së konfliktit, nga muaji maj deri në muajin nëntor të vitit 2001, u formua Qeveri e Koalicionit të Gjerë e cila përfshiu ministra nga LSDM dhe PLD.

Në vitin 2002 VMRO-DPMNE fitoi 33 mandate deputetësh, i humbi zgjedhjet dhe funksionoi si opozitë deri në vitin 2006. Në vitin 2003 në Kongresin partiak kryetari shumëvjeçar i Partisë Lubço Georgievski dha dorëheqje, ndërsa në vend të tij erdhi Nikolla Gruevski. Vitin e ardhshëm një pjesë e madhe e udhëheqësisë paraprake, në krye me ish-kryetarin Lubço Georgievski, e braktisën partinë dhe si rezultat i kësaj pasojnë ndryshime të mëdha në udhëheqësin partiake. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, Koalicioni VMRO-DPMNE me disa parti më të vogla fitoi 45 mandate të deputetëve dhe formoi Qeveri në koalicion me Partinë e Re Social-Demokrate (PRSD) dhe me PDSH-në. Në këto zgjedhje partia për të parën herë doli me Program konkret dhe me afate konkrete, që paraqiste risi në garat zgjedhore. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të vitit 2008, VMRO-DPMNE fitoi 63 mandate dhe korri fitoren e saj më të madhe zgjedhore. Në zgjedhjet e ardhshme të parakohshme parlamentare të vitit 2011, VMRO-DPMNE sërish fitoi me 53 mandate dhe me 3 mandate të diasporës të cilat u inkorporuan pikërisht prej këtyre zgjedhjeve. Gjatë gjithë periudhës, prej vitit 2006 e këtej, kryetar i qeverive të VMRO-DPMNE është lideri i partisë Nikolla Gruevski.

Në zgjedhjet e para lokale të vitit 1996, VMRO-DPMNE bashkë me MAAK-Konservative fituan 26 komuna. Në zgjedhjet lokale të ardhshme të vitit 2000 fitoi 59 vende të kryetarëve të komunave por në vitin 2005 i humb 37 prej tyre, përkatësisht bashkë me partnerët e koalicionit dhe me mbështetjen e kandidatit të pavarur për Qytetin e Shkupit fitoi 22 vende të kryetarëve të komunave. Në zgjedhjet e ardhshme lokale, të mbajtura në vitin 2009, fitoi 56 vende të kryetarëve të komunave dhe bindshëm kthehet në pushtet në nivel lokal. Me rezultatin e zgjedhjeve lokale të vitit 2009, VMRO-DPMNE imponohet si parti dominuese në pushtet në nivel nacional dhe lokal.

VMRO-DPMNE
Rr. "Makedonia" 17a
1000 Shkup
Tel: 3215 550
Faks: 3215 551, 3290 663
contact@vmro-dpmne.org.mk
www.vmro-dpmne.org.mk

LIDHJA SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË (LSDM)

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë deklarohet si parti e qendrës së majtë, me proveniencë ideologjike socialdemokrate. Sipas madhësisë është partia e dytë në Maqedoni. U themelua në Kongres në muajin prill të vitit 1991, si pasardhës juridik i Lidhjes së Komunistëve të Maqedonisë – Partia për Transformim Demokratik (LKM-PTD). Për kryetar partie, në Kongresin e njëjtë, në moshë 28 vjeçare, u zgjodh Branko Cërvenkovski, i cili është në krye të partisë deri në zgjedhjen e tij për President të Republikës së Maqedonisë, në muajin maj të vitit 2004. Sot Branko Cërvenkovski sërish është kryetar i partisë.

Në zgjedhjet e para shumë-partiake në nëntor të vitit 1990 LSDM me emërtimin e atëhershëm LKM-PTD, fitoi 24.08% të votave. Në shtator të vitit 1992, pas shpërndarjes së Qeverisë së parë eksperte, LSDM e fiton mandatin që ta formojë Qeverinë e parë politike të Republikës së Maqedonisë në krye me kryetarin e saj Branko Cërvenkovski. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1994 bashkë me partnerët e tij të koalicionit, fitoi 85 vende të deputetëve dhe formoi Qeveri, kryetar i sërishëm i së cilës ishe Branko Cërvenkovski. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1998 LSDM fitoi 27 vende të deputetëve dhe e humbi pushtetin, por u bë partia më e madhe opozitare në periudhën deri në vitin 2002. Në periudhën nga muaji maj deri në muajin nëntor të vitit 2001, LSDM u bë pjesë e Qeverisë së koalicionit të gjerë. Në zgjedhjet e rregullta parlamentare të vitit 2002, LSDM fitoi 60 vende të deputetëve me ç'rast sërish e formoi Qeverinë në krye me Branko Cërvenkovskin. Pas zgjedhjes së Branko Cërvenkovskit për President të Republikës së Maqedonisë në vitin 2004, Kryetar i Qeverisë u bë Hari Kostov, i cili paraprakisht e ushtronte funksionin e ministrit të Punëve të Brendshme. Pas dorëheqjes së tij, në nëntor të vitit 2004, për kryetar të LSDM u zgjodh Vllado Buçkovski, me ç'rast iu besua mandati

për formimin e Qeverisë. Në zgjedhjet e vitit 2006, koalicioni i LSDM, me partitë më të vogla politike, fitoi 32 vende të deputetëve, e humb pushtetin dhe përsëri kthehet në opozitë. Në periudhën kohore nga muaji nëntor 2008 deri muajin shtator 2008 kryetare e LSDM ishte Radmilla Sheqerinska. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008 koalicioni i njëjtë fitoi 27 vende të deputetëve. Në zgjedhjet e ardhshme të parakohshme parlamentare të vitit 2011, koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi 42 vende të deputetëve, me ç'rast e rriti influencën e vet opozitare në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Në zgjedhjet lokale të vitit 1996, LSDM fitoi 54 vende të kryetarëve të komunave, me çka u bë partia me më shumë mandate të fituara në ato zgjedhje. Në historinë më të re demokratike maqedonase të zgjedhjeve lokale në vitin 2000, koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi 32 vende të kryetarëve të komunave, ndërkaq në vitin 2005 suksesi i tij u rrit, me ç'rast LSDM fitoi 36 vende të kryetarëve të komunave, me çka mbetet parti dominuese sipas numrit të kryetarëve të komunave. Në vitin 2009 LSDM humb një numër të madh të komunave në të cilat ishte në pushtet, fiton 6 vende të kryetarëve të komunave plus një vend të kryetarëve të komunës si pjesë e koalicionit.

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
Rr. "Pavel Shatev" nr. 8
1000 Shkup
Tel: 3293 100
Faks: 3293 109
web@sdsm.org.mk
president@sdsm.org.mk
www.sdsm.org.mk

BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM (BDI)

Bashkimi Demokratik për Integrim lindi nga ish-pjesëtarët të ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), e cila e filloi konfliktin e armatosur në vitin 2001. Nga aspekti ideologjik BDI deklarohet si parti e qendrës së majtë, e cila angazhohet për të drejta më të mëdha të shqiptarëve dhe për implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Partia u themelua më 5 maj të vitit 2002 dhe për të parën herë mori pjesë në zgjedhjet parlamentare të të njëjtit vit, në të cilat fitoi numër më të madh votash në elektoratin etnik shqiptar dhe u bë pjesë e Qeverisë së udhëhequr nga LSDM. Që nga themelimi e deri më sot kryetar i partisë është Ali Ahmeti. BDI ishte pjesë e Qeverisë nga viti 2002 deri në vitin 2006, me ç'rast u prezantua me numër më të madh të ministrave që një parti shqiptare i ka pasur në Qeverinë e RM-së.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, BDI sërish e fitoi numrin më të madh të votave të elektoratit shqiptar (12.2%), mirëpo pas negociatave të pasuksesshme me VMRO-DPMNE nuk u përfshi në koalicionin e atëhershëm qeveritar. Si rezultat i kësaj, BDI një periudhë më të madhe i bojkotoi punimet në Kuvend nga viti 2006 deri në vitin 2008 kur edhe u shpallën zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2008, BDI fitoi 12.8% të votave dhe si parti më e madhe politike e cila i përfaqëson shqiptarët etnik u bë pjesë e Qeverisë në krye të së cilës ishte Nikolla Gruevski. Në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2011, BDI sërish është partia e tretë për nga madhësia, sa i përket numrit të votave të fituara dhe mandateve të deputetëve në Maqedoni (10.28%), përkatësisht 15 mandate dhe përsëri është pjesë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Nga themelimi i saj e deri më sot, BDI ka marrë pjesë në dy cikle zgjedhore të zgjedhjeve lokale. Në zgjedhjet e vitit 2005 dhe në ato të vitit 2009, BDI fitoi 15 vende të kryetarëve të komunave, por në vitin 2009 e humbi Tetovën dhe Gostivarin, komuna këto me shumicë të popullatës etnike shqiptare

Bashkimi Demokratik për Integrim
Rr. Reçicë e Vogël
1200 Tetovë
Tel: 044 334 398
press@bdi.mk
www.bdi.mk

PARTIA DEMOKRATIKE SHQIPTARE (PDSH)

PARTIA DEMOKRATIKE SHQIPTARE

Partia Demokratike Shqiptare u themelua në Qershor të vitit 1997 me bashkimin e Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH) dhe Partisë Demokratike Popullore (PDP). PPDSH u themelua në vitin 1994, pasi që krahu radikal i Partisë për Prosperitet Demokratik (PPD), Arben Xhaferi dhe Menduh Thaçi e braktisën partinë amë. PDSH deklarohet si parti e qendrës së djathtë dhe angazhohet për të drejta më të mëdha të shqiptarëve në Maqedoni dhe për ridefinimin e kornizës kushtetuese të vendosur me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Kryetar i PDSH-së është Menduh Thaçi, i cili në këtë funksion u zgjodh më 30 qershor të vitit 2007. Thaçi e merr funksionin e ri pas dorëheqjes së kryetarit paraprak Arben Xhaferi.

Në zgjedhjet e vitit 1998 PDSH fitoi 24 vende të deputetëve dhe u bë pjesë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Gjatë kohës së konfliktit të vitit 2001, PDSH mbetet pjesë e Qeverisë dhe e koalicionit të gjerë, e cila më vonë e nënshkroi Marrëveshjen Kornizë. Nënshkrues i Marrëveshje Kornizë nga ana e PDSH-së ishte kryetari i saj i atëhershëm Arben Xhaferi. Pas prishjes së asaj Qeverie, PDSH mbetet pjesë e koalicionit qeveritar.

Në zgjedhjet e radhës parlamentare të vitit 2002 PDSH fitoi 5.2% të votave dhe 7 mandate dhe u bë opozitë në Kuvendin e RM-së. PDSH përsëri kthehet në pushtet kur pas zgjedhjeve të vitit 2006 me sukses i përfundoi negociatat me VMRO-DPMNE e cila e fitoi mandatin për formimin e Qeverisë. Në këto zgjedhje PDSH fitoi 7.5% të votave dhe 11 mandate që ishte numër më i vogël nga mandatet e partisë rivale BDI. Në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2008 PDSH përsëri fitoi 11 mandate, ndërsa në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2011 fitoi 8 vende të deputetëve. Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2008 partia më e madhe parlamentare VMRO-DPMNE e ndërpreu partneritetin tradicional me PDSH dhe formoi koalicion me partinë më të madhe shqiptare në Parlament me BDI-në.

Në zgjedhjet e vitit 2005 PDSH fitoi dy vende të kryetarëve të komunave, ndërsa në zgjedhjet e ardhshme të vitit 2009 fitoi një vend të kryetarit të komunës në Tetovë.

Partia Demokratike Shqiptare
Qendra e Qytetit 15/1
1200 Tetovë
Tel: 044 333 581
Faks: 044 333 581
info@gurra-pdsh.org
www.pdsh.info

RILINDJA DEMOKRATIKE KOMBËTARE (RDK)

Rilindja Demokratike Kombëtare u themelua në muajin mars të vitit 2011, si parti më e re politike në bllokun etnik shqiptar. Ideologjikisht RDK pozicionohet si parti e qendrës së djathtë, si parti me përcaktim demokratik dhe kombëtar dhe angazhohet për avancimin e të drejtave dhe lirive personale dhe kombëtare të shqiptarëve etnik në Maqedoni. Kryetari dhe themeluesi i partisë Rufi Osmani, aktualisht është kryetar i Komunës Gostivar. RDK ka 12 këshilltarë në Këshillin e Komunës Gostivar, i cili përbëhet nga 31 anëtarë. Anëtarët e kësaj partie, në zgjedhjet lokale të vitit 2009, morën pjesë si kandidatë të pavarur. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2011, RDK fitoi 2.67% të votave të përgjithshme dhe dy mandate të deputetëve.

Rilindja Demokratike Kombëtare
Rr. Bitpazarska 60
Shkup
Tel: 5511 371, 550 551
info@rdk.org.mk ; press@rdk.org.mk
www.rdk.org.mk

UNIONI SOCIAL-DEMOKRATIK (USD)

Unioni Social-Demokratik u themelua në vitin 2008 pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare nga tre anëtarë të udhëheqësisë së Partisë së Re Social-Demokratike (PRSD) Llazar Elenovski, Vera Rafajllovska dhe Vele Mitanovski. Kryetar i parë i partisë u zgjodh Llazar Elenovski, ndërkaq nga muaji qershor i vitit 2012 kryetar i partisë u zgjodh Çedo Nikollovski. USD është parti qytetare me ideologji social-demokratike dhe angazhohet për integrimin e Maqedonisë në NATO dhe BE. USD ka 5 këshilltarë në organet e njësive të vetëqeverisjes lokale, ndërkaq nuk ka kryetar komune ose deputetë. Në zgjedhjet e fundit të parakohshme parlamentare të vitit 2011 USD fitoi 2 207 vota, përkatësisht (0.20%).

Unioni Social-Demokratik
Rr. 164 nr. 10A
1000 Shkup
Tel: 070 268 045, 078 078 370 201, 076 268 045
info@sdu.org.mk
www.sdu.org.mk

PARTIA SOCIAL-DEMOKRATIKE E MAQEDONISË (PSDM)

Partia Social-Demokratike e Maqedonisë (PSDM) u themelua në vitin 1990. Kryetar i parë i saj u zgjodh Sllavko Millosavlevski. PSDM pozicionohet si parti e qendrës së majtë dhe në mënyrë deklarative e pranon ideologjinë socialdemokrate si bazë për veprimin e saj. Kryetar aktual është Branko Janevski i cili është në krye të partisë në mandatin e tij të tretë.

Për momentin, PSDM ka dy vende të këshilltarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Kjo parti ka marrë pjesë në të gjitha ciklet zgjedhore në Maqedoninë pluraliste, por pa ndonjë sukses të konsiderueshëm. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2011, PSDM fitoi 1807 vota (0.16%) në territorin e Republikës së Maqedonisë. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013, PSDM do të merr pjesë në mënyrë të pavarur me kandidatë të vet për kryetarë të komunave dhe me lista të veta për këshilltarë.

Partia Social-Demokratike e Maqedonisë (PSDM)
Bul. JNA nr. 54 ndërtesa nr. 1, hyrja 1 përdhes
Shkup

LËVIZJA POPULLORE E MAQEDONISË (LPM)

Lëvizja Popullore e Maqedonisë u themelua më 18 maj të vitit 2002 si parti me orientim kombëtar e bazuar mbi traditën e popullit maqedonas, e cila përpiqet për shtet social dhe tatim për të pasurit. Kryetar i LPM-së është Janko Baçev. Partia është pjesë e koalicionit "Për Maqedoni më të mirë", por në këto zgjedhje lokale do të merr pjesë si e pavarur. LPM ka 2 këshilltarë në organet e njësive të vetëqeverisjes lokale, ndërkaq nuk ka kryetar të komunave ose deputetë.

Lëvizja Popullore e Maqedonisë
Rr. Dame Gruev 10
1000 Shkup
Tel: 310 1999, 3101 990, 075 335 013, 070 387 171
ndm@ndm.org.mk
www.ndm.org.mk

FORCAT E BASHKUARA DEMOKRATIKE TË ROMËVE (FBDR)

Forcat e Bashkuara Demokratike të Romëve u themelua në dhjetor të vitit 2012 me bashkimin e Partisë së Bashkuar për Emancipim (PBE) dhe Forcave Demokratike të Romëve (FDR) me qëllim që bashkërisht të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2013 dhe që ta përforcojnë pozitën e tyre në skenën politike. Kryetar i partisë është Shaban Saliu. Partia angazhohet për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të bashkësisë rome në administratën publike dhe në të gjitha fushat komunale. FBDR aktualisht ka 6 këshilltarë në organet e vetëqeverisjes lokale. Këto parti janë në koalicion me VMRO-DPMNE.

Forcat e Bashkuara Demokratike të Romëve
Rr. Shuto Orizarë nr. 56
1000 Shkup

LIDHJA E ROMËVE TË MAQEDONISË (LRM)

Lidhja e Romëve të Maqedonisë është parti e cila i përfaqëson interesat e bashkësisë etnike rome në Maqedoni, aktive në skenën politike nga fundi i vitit 1990. Kryetar i partisë është Amdi Bajram. Në periudhën kohore 1998-2002 kjo parti ishte pjesë e punimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë me një deputet. Nga viti 2006 e deri më sot LRM përsëri përfaqësohet me një deputet në Kuvend, si pjesë e koalicionit të VMRO-DPMNE.

Në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2009, Lidhja e Romëve fitoi 6 vende të këshilltarëve dhe një vend të kryetarit të Komunës Shuto Orizarë. Në zgjedhjet e vitit 2013 kjo parti do të garojë me një kandidat për kryetar komune dhe me një listë të këshilltarëve në Komunën Shuto Orizarë.

Lidhja e Romëve të Maqedonisë
Rr. Vashingtonska nr. 67
Shkup

PARTIA PËRPARIMTARE SERBE NË MAQEDONI (PPSM)

Partia Përparimtare Serbe në Maqedoni është njëra nga partitë politike të bashkësisë serbe në Republikën e Maqedonisë. Deklarativisht, partia angazhohet për ruajtjen e identitetit etnik serb në Maqedoni. U themelua në vitin 2006, ndërsa kryetar i saj është Dragisha Miletiq. PPSM ka një deputet në Kuvendin e RM-së dhe pesë këshilltarë në organet e njësive të vetëqeverisjes lokale në Maqedoni.

Partia Përparimtare Serbe
Rr. Dame Gruev nr. 10
1000 Shkup

KOALICIONE

„ALEANCA PËR ARDHMËRI"

„Aleanca për Ardhmëri" është bllok koalicioni i partive opozitare në Republikën e Maqedonisë, i udhëhequr nga LSDM. Në kuadër të koalicionit, merr pjesë edhe Partia e Re Social-Demokratike, Partia për Ardhmëri Evropiane, Partia Liberale e Maqedonisë,[42] Lëvizja për Unitet Nacional të Turqve në Maqedoni, Partia Përparimtare Serbe në Maqedoni, Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve, Alternativa e Re, Lidhja e Forcave të Majta të Titos, Partia për Lëvizjen e Turqve në Maqedoni, Lidhja Demokratike e Serbëve në Maqedoni, Lidhja Demokratike e Vllehve në Maqedoni, Partia e Demokratëve të Lirë, Partia e Pensionistëve të RM-së dhe Liga e Sanxhakut.

Në tetor të vitit 2012 bllokut të koalicionit opozitar iu bashkëngjit Partia Liberal Demokratike, VMRO-Partia Popullore, "Donstoinstvo" dhe të Bashkuar për Maqedoninë. Koalicioni u konfirmua me Deklaratën e përbashkët për bashkëpunim për zgjedhjet lokale të radhës. Qëllimi kryesor i "Aleancës për Ardhmëri" është ndryshimi i Qeverisë të udhëhequr nga VMRO-DPMNE.

"Aleanca për Ardhmëri" nuk merr pjesë në zgjedhjet lokale, por dy parti nga ky koalicion, Partia për Ardhmëri Evropiane dhe Partia Përparimtare Serbe paraqitën kandidatë të tyre në disa komuna. Për momentin ky koalicion funksionon si opozitë jashtëparlamentare në shenjë proteste ndaj politikave të partisë në pushtet.

Më datë 24 shkurt të vitit 2013 "Aleanca për Ardhmëri" e promovoi Deklaratën e vet për rindërtimin e demokracisë, lirisë dhe drejtësisë në Republikën e Maqedonisë. Me këtë, u konfirmua vendimi për bojkotimin e zgjedhjeve lokale të vitit 2012 nga të gjithë partnerët e Koalicionit, me përjashtim të Partisë Liberale dhe Partisë Përparimtare Serbe në Maqedoni. Deklarata në pesë pika i thërret qytetarët t'i bojkotojnë zgjedhjet lokale dhe paralajmëron kthimin e mandateve të deputetëve të opozitës në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve. Zgjedhjet e radhës janë vlerësuar si jolegjitime dhe parashikohet revizion përmes anulimit dhe mbajtjes së sërishme pas ndryshimit të pushtetit aktual qendror në zgjedhjet eventuale të parakohshme.[43]

Me marrëveshjen, nga data 01.03.2013, të arritur ndërmjet VMRO-DPMNE dhe LSDM, LSDM ra dakord që të merr pjesë në zgjedhjet lokale.

„PËR MAQEDONI MË TË MIRË"

Në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2009, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE përbëhej nga 18 parti: Partia Socialiste e Maqedonisë, Lidhja Demokratike, Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë-RDM, Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni, Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni, Lidhja e Romëve në Maqedoni, Partia e Bashkuar për Emancipim, Partia e Drejtësisë, Partia e Aksionit Demokratik në Maqedoni-PAD, Partia e Vllehve në Maqedoni, Partia për Integrimin e Romëve, Partia Demokratike Boshnjake-PDB, Forcat Demokratike të Romëve-FDR, Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas-BPRM, Partia e Re Liberale, Lëvizja Popullore për Maqedoninë, VMRO-Partia Demokratike, VMRO-të Bashkuar, Organizata Maqedonase Atnore për Rindërtim Radikal-Vardar-Egje-Pirin-TMRO-VEP, Aleanca Maqedonase dhe VMRO-Maqedonase. Ky Koalicion nuk ka logo të veçantë, përkatësisht shfrytëzohet logoja e VMRO-DPMNE. Platforma rreth së cilës bashkohen këto parti për zgjedhjet lokale të radhës të vitit 2013, sikurse edhe gjatë cikleve paraprak zgjedhor, janë programet zgjedhore të VMRO-DPMNE. Programi i fundit nga viti 2011 është titulluar si: "Manifest për reforma dhe zhvillim".

Koalicioni i VMRO –DPMNE arriti të sigurojë fitore në të gjitha ciklet zgjedhore nga viti 2006 deri më sot, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për zgjedhje parlamentare, presidenciale ose lokale.

[42] Ivon Veliçkovski, kryetar i Partisë Liberale: "Në zgjedhjet lokale shkojmë vet, por Koalicioni me LSDM vazhdon", "Nova Makedonia" 07.03.2013.

[43] Teksti integral i Deklaratës së "Aleancës për Ardhmëri" mund të shihet në ueb faqen e LSDM-së. I arritshëm më 25.02.2013:<http://sdsm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=7982>

ПРЕГЛЕД НА КАНДИДАТИ ЗА ГРАДОНАЧАЛНИЦИ НА ЛОКАЛНИТЕ ИЗБОРИ 2013

PASQYRA E KANDIDATËVE PËR KRYETARË TË KOMUNAVE



Organizimi territorial i vetëqeverisjes lokale 2013.[44]

Burimi: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

Në këtë pjesë janë prezantuar kandidatët për kryetarë të komunave,[45] të cilët do të garojnë për fitimin e besimit të qytetarëve në Zgjedhjet Lokale të vitit 2013. Personat e nominuar në 29 komunat dhe Qytetin e Shkupit[46]

[44] Për të gjitha fotografitë për të cilat si burim është shfrytëzuar interneti, është theksuar linku i saktë i burimit. Fotografitë e kandidatëve për kryetarë të komunave të VMRO-DPMNE janë marrë nga: http://gradonacalnici.mk/

[45] Në afatin plotësues për paraqitjen e kandidaturave, 8 mars 2013, kandidatura për kryetar të komunave dhe lista të këshilltarëve paraqitën edhe Koalicioni i udhëhequr nga LSDM – "Aleanca për Ardhmëri", Partia Liberale, Aleanca Republikane (AR) dhe Lëvizja për Unitet Nacional të Turqve (LUNT).

[46] Prezantimi i kandidatëve për kryetarë të komunave, në 29 komuna dhe në Qytetin e Shkupit është bërë sipas rendit alfabetik

janë prezantuar me biografitë dhe fotografitë e tyre, ndërsa kandidatët nga komunat e tjera janë cekur vetëm me emrat dhe mbiemrat e tyre, si dhe me paraqitësin e kandidaturës.[47]

Në pasqyrën gjithëpërfshirëse janë përfshirë vetëm komunat më të mëdha, të cilat janë locuar në mjediset urbane, duke i përfshirë edhe të gjitha komunat në kuadër të Qytetit të Shkupit. Kriteret për përfshirjen e komunave në ekzemplarin ishin: statusi urban, numri i banorëve (me ç'rast janë përfshirë më të mëdhatë), struktura etnike e popullsisë (me ç'rast mbahej llogari që të përfshihen sa më shumë komuna multietnike) dhe numri i kandidatëve të nominuar për kryetar të komunave.

[47] Gjatë ecurisë së hartimit të kësaj broshure kontaktuam numër të madh të kandidatëve për kryetarë të komunave dhe parti të cilat i përfaqësojnë, në mënyrë që t'i sigurojmë biografitë dhe fotografitë e personave të nominuar. Në vazhdim i prezantojmë vetëm ata kandidatë të cilët iu përgjigjën kërkesës sonë dhe ata kandidatë, fotografitë dhe të dhënat e të cilëve janë publikuar në hapësirën e Internetit. Ata kandidatë, të cilët nuk janë prezantuar me biografi dhe fotografi, nuk i kanë dërguar të dhënat e tyre brenda afatit të caktuar dhe prandaj këtu janë prezantuar vetëm me emrat dhe mbiemrat e tyre, si dhe me paraqitësin e kandidaturës.

Qyteti i Shkupit

Sipërfaqja	1854 км^2
Numri i banorëve	506,926
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (66,75%), Shqiptarë (20,49%), Romë (4,36%), Serbë (2,82%), Turq (1,70%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	45
Buxheti për vitin 2012[48]	5,903,415,000
Adresa	Bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup
Telefoni	02/ 3 297 255; 02/ 3 297 536; 02/ 3 297 265; 02/ 3 297 236;
Faqja e Internetit	http://www.skopje.gov.mk

KANDIDATË PËR KRYETAR TË QYTETIT TË SHKUP

Artan Grubi (BDI)[49] për momentin e ushtron funksionin shef i kabinetit të Kryetarit të BDI-së. Ka përvojë katërmbëdhjetëvjeçare në organizata të ndryshme ndërkombëtare në Maqedoni dhe rajon, përfshirë edhe NATO, Tribunalin e Hagës dhe Ambasadën e Mbretërisë së Holandës në Shkup. Ai është njëri nga themeluesit e Lëvizjes Qytetare "Zgjohu!". Ka diplomuar dhe magjistruar në Fakultetin Juridik në Shkup, studime për gazetari, ndërsa për momentin është doktorantë në fakultetin e njëjtë. Ka 35 vjet.

[48] Buxhetet e të gjitha komunave të prezantuara në këtë Manual janë shprehur në denarë.
[49] http://zhurnal.mk/data/news/Artan-Grubi_1.jpg

Bekim Fazliu (PDSH)[50] është deputet në Republikën e Maqedonisë. Ai është kryetar i Komisionit të Përhershëm për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarëve, si dhe anëtar i Komisionit Juridik-Ligjvënës dhe i Komisionit për Vetëqeverisje Lokale. Nga viti 2009 deri në zgjedhjen e tij për deputet, ka qenë këshilltar në Qytetin e Shkupit. Nga zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës Saraj, nga viti 2007 deri në vitin 2009, Fazliu e ka ushtruar funksionin e kryetarit të kësaj Komune. Ka kryer Fakultetin Juridik në Shkup. Fazliu ka 33 vjet.

Gabriella Arsova Milloshevska (Aleanca Republikane)[51] është themeluese dhe kryetare e partisë Aleanca Republikane. Në të kaluarën ka punuar në më shumë ndërmarrje ndërtimore. Ka qenë këshilltare për monitorimin dhe mbikëqyrjen e objekteve arsimore në Ministrinë e Arsimit, Seksioni për punë ndërtimore (1999-2001) dhe këshilltare në Byronë për Zona të Pazhvilluara (2001-2002). Ka diplomuar në Fakultetin e Makinerisë në Shkup, Dega Menaxhmenti Industrial, ndërsa në Fakultetin Filozofik në Shkup është pajisur me kualifikimin për ushtrimin e veprimtarisë arsimore. Për momentin është doktorante në Fakultetin e Makinerisë. Ka 43 vjet.

Goran Nikollovski (PL) është docent në Fakultetin e Mjekësisë të Veterinarisë në Shkup ku punon tanimë 19 vjet. Në periudhën kohore nga viti 2005 deri në vitin 2009 ka qenë kryetar i Bordit Drejtues të NP Kopshti Zoologjik i Qytetit të Shkupit. Ka diplomuar në Fakultetin e Veterinarisë në Zagreb, ndërsa ka magjistruar dhe doktoruar në Fakultetin e Mjekësisë të Veterinarisë në Shkup. Ka 44 vjet.

Zhaklina Nikoliq (USD)

Zllate Vojnovski (LPM)

[50] http://zurnal.mk/content.asp?id=201212301932
[51] https://www.facebook.com/paradise.ag?fref=ts

Jani Makraduli (LSDM)[52] aktualisht është nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Ai është kryetar i Këshillit të Kanalit të Kuvendit, ndërkaq është anëtar i Komisionit për Çështje Evropiane dhe Komisionit për Transport, Lidhje dhe Ekologji. Funksionin e deputetit e ushtron tanimë 12 vjet, kur në shtator të vitit 2001 fiton në zgjedhjet plotësuese mazhoritare për zgjedhje të deputetëve. Para se të bëhet deputet ka qenë shef i Laboratorit pranë Institutit për Teknikë Kompjuterike dhe Informatikë në Fakultetin Elektroteknik në Shkup, në të cilin ka qenë asistent dhe ka punuar gjatë 11 viteve paraprakë. Ka publikuar mbi 40 punime shkencore dhe publikime. Makraduli ka diplomuar dhe magjistruar në Fakultetin Elektroteknik në Shkup. Ai ka 48 vjet.

Koce Trajanovski (VMRO-DPMNE) është kryetar aktual i Qytetit të Shkupit. Paraprakisht, nga viti 2005 deri në vitin 2009, ishte kryetar i Komunës Gazi Babë - Shkup. Nga viti 2008 është kryetar i Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNjVL). Nga viti 1998 deri në vitin 2005 ishte deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Para se të fillojë të merret me politikë, kishte firmën e tij për kompjuterë, ndërkaq 15 vjet ka punuar në EMT-Hepos. Trajanovski ka diplomuar në Fakultetin e Makinerisë në Shkup. Ai ka 57 vjet.

Lulzim Faziri (RDK) punon si nëpunës shtetëror në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. Paraprakisht, nga viti 2009 deri në vitin 2011, ka punuar në Qeverinë e RM-së – Sektori për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ndërsa nga viti 2004 deri në vitin 2009 ka punuar në Ministrinë e Drejtësisë. Ka doktoruar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Cilrili dhe Metodi" – Shkup, me ç'rast e ka fituar titullin Doktor i shkencave politike. Posedon njohuri të shkëlqyeshme në punën me kompjuter dhe gjuhën angleze. Ka 28 vjet.

[52] https://www.facebook.com/janimak?fref=ts

Komuna Aerodrom

Sipërfaqja	21 км^2
Numri i banorëve	72,009
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (89,42%), Serbë (4,28%), Shqiptarë (1,41%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	27
Buxheti për vitin 2012	1,785,561,126
Adresa	Rr. "Venijamin Maçukovski" nr. 6, 1000 Shkup
Telefoni	02/ 2 400 970
Faqja e Internetit	http://www.aerodrom.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË AERODROM



Dime Vellkovski (LSDM[53] punon në Ndërmarrjen Publike "Parqe dhe Gjelbërime" në të cilën nga viti 2005 deri në vitin 2006 e ka ushtruar funksionin drejtor i përgjithshëm, ndërsa nga viti 2006 deri në vitin 2009 ka qenë drejtor teknik. Vellkovski është inxhinier i diplomuar i bujqësisë, ndërkaq aktualisht është në studime pos diplomike për agro-ekonomi në Fakultetin e Bujqësisë në Shkup. Ai është edhe Vlerësues i autorizuar i kualitetit të ushqimit. Vellkovski ka 39 vjet.

Dragoljub Jaqoski (PSDM)

Ivica Konevski (VMRO-DPMNE) është kryetar i Komunës Aerodrom nga viti 2009. Paraprakisht, nga viti 2006 deri në zgjedhjen për kryetar komune e ka ushtruar funksionin drejtor i përgjithshëm i Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Lokale Banesore dhe Afariste të Republikës së Maqedonisë. Në vitin 2005 dhe 2006 është anëtar i Këshillit të Qytetit të Shkupit. Konevski është jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës. Ai ka 34 vjet.

[53] https://www.facebook.com/DimeVelkovskiZaAerodrom?fref=ts

Maja Millovanoviq Mihajlloviq (USD)

Mimica Antovska (PL) është menaxhere e financave. Në periudhën kohore nga viti 2005 deri në vitin 2009 ka qenë anëtare e Këshillit të Komunës Aerodrom. Antovska është ekonomiste e diplomuar. Ka 48 vjet.

Komuna Butel

Sipërfaqja	55 км^2
Numri i banorëve	36,154
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (62,25%), Shqiptarë (25,19%), Turq (3,61%), Serbë (2,86%), Boshnjakë (2,68%), Romë (1,55%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	19
Buxheti për vitin 2012	400,000,000
Adresa	Bul. "Bosnja e Hercegovina" p.n., 1000 Shkup
Telefoni	02/ 2 600 506
Faqja e Internetit	http://www.opstinabutel.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË BUTEL

Alil Palloshi (BDI)

Gjorgje Sekovski (USD)

Ermond Miftari (PDSH)

Kosta Naçevski (LSDM)[54] ka diplomuar për biznes administratë në Euro Kolexhin në Kumanovë. Ka 35 vjet.

Petar Mandalov (PSDM)

Petre Llatinoski (VMRO-DPMNE) e ushtron mandatin e tij të dytë si kryetar i Komunës Butel dhe është kryetari i parë i kësaj komune. Nga viti 1999 deri në vitin 2003 punon si drejtor në SHMSH për ekonomi dhe biroteknikë "Arseni Jovkov", ndërsa nga viti 1978 deri në vitin 1999 punon si profesor në këtë shkollë. Ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës pranë Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" , dega Gjeografi. Ka 58 vjet.

[54] https://www.facebook.com/KostaNachevskiZaButel?fref=ts

Komuna Gazi Babë

Sipërfaqja	92 км^2
Numri i banorëve	72,617
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (73,67%), Shqiptarë (17,22%), Serbë (2,89%), Romë (2,87%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	27
Buxheti për vitin 2012	730,129,000
Adresa	Rr. "Aleksandar Makedonski" p.n., 1000 Shkup
Telefoni	02/ 3 226 655
Faqja e Internetit	http://www.gazibaba.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GAZI BABË

Aleksandar Bezhovski (PL) është drejtor i AB INKonsalt tanimë 13 vjet. Nga viti 2001 deri në vitin 2003 ka punuar si udhëheqës i Seksionit për bashkëpunim ndërkombëtar doganor në Drejtorinë e Doganave të Republikës së Maqedonisë, ndërsa nga viti 2000 deri në vitin 2001 ka qenë këshilltarë për eurointegrime në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Para se të punësohet në administratën shtetërore katër vjet, nga viti 1996 deri në vitin 2000 ka qenë drejtor i firmës familjare VIZA-B, Shkup. Bezhovski ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Shkup në të cilin ka magjistruar në fushën e të drejtës ndërkombëtare. Ka 37 vjet.

Borçe Stefanovski (VMRO-PP)[55] është pronar i kompanisë private për tregti me shumicë dhe pakicë, të cilën e ka themeluar në vitin 1990. Nga viti 1999 e deri më sot është kryetar i Këshillit Drejtues të Fermës për Pulari "Belimbegovë". Në periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2005 ka qenë kryetar i Komunës Gazi Babë. Nga viti 2007 deri në vitin 2009 ka punuar si koordinator i punëve të ndërmarrjeve publike të Qytetit të Shkupit dhe ndihmës udhëheqës i Sektorit për Financa i Qytetit të Shkupit. Nga viti 1996 është nënkryetar i Karate Klubit "Metalurg"- Shkup. Ka diplomuar dhe magjistruar në Fakultetin Ekonomik në Shkup. Ka 46 vjet.

Goce Dellçev Todev (USD)

Muhadin Murtezani (PDSH)

Nikolla Papadinovski (PSDM)

Toni Trajkovski (VMRO-DPMNE) e ushtron mandatin e tij të parë si kryetar i Komunës Gazi Babë. Deri në zgjedhjen e kryetarit të komunës në vitin 2009 ka qenë i punësuar në SHA "Elem", ndërkaq paraprakisht ka punuar edhe si inxhinier në SHA "ESM". Nga viti 2005 është anëtar i Këshillit të Komunës së Gazi Babës, ndërsa nga viti 2008 është kryetar i Këshillit të Komunës. Trajkovski ka diplomuar në Fakultetin e Makinerisë në vitin 2001 në Shkup. Ka 39 vjet.

[55] https://www.facebook.com/BorceStefanovskiKandidatZaGradonacalnikNaGaziBaba

Komuna Gjorçe Petrov

Sipërfaqja	67 км^2
Numri i banorëve	41,634
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (85,16%), Shqiptarë (3,84%), Serbë (4,16%), Romë (3,00%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	23
Buxheti për vitin 2012	726,913,000
Adresa	Rr. "Gjorçe Petrov" nr. 73, 1000 Shkup
Telefoni	02/ 2 039 307; 02/ 2 039 308
Faqja e Internetit	http://www.opstinagpetrov.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GJORÇE PETROV

Aleksandar Naumoski (LSDM)[56] punon në "Eurolink Sigurimi" SHA Shkup, si likuidator i dëmeve sipas kartonit të gjelbër. Para vitit 2011 ka qenë bashkëpunëtor në Ministrinë e Drejtësisë në Sektorin për Mbështetjen e Agjentit Qeveritar, po ashtu ka punuar edhe si këshilltar i drejtorit të përgjithshëm për çështje juridike pranë Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë. Naumoski ka diplomuar dhe magjistruar në Fakultetin Juridik në Shkup. Ka 35 vjet.

Mirko Ristovski (USD)

Svetozar Dimovski (PSDM)

Sokol Mitrevski (VMRO-DPMNE) e ushtron mandatin e tij të dytë si kryetar i Komunës Gjorçe Petrov. Ai është njëri nga themeluesit e Fakultetit të Mbrojtjes në Shkup, si dhe profesor shumëvjeçar në Akademinë Ushtarake në Shkup. Ka qenë anëtarë dhe adjutant në Kabinetin e Presidentit Kiro Gligorov dhe Boris Trajkovski të Republikës së Maqedonisë. Sot është gjeneral i pensionuar. Arsimin e lartë e ka kryer në Akademinë Ushtarake në Beograd, Kolegj Ushtarak në Paris, si dhe shkolla të tjera ushtarake. Ka 65 vjet.

[56] https://www.facebook.com/photo.php?fbid=222169054596606&set=a.157399577740221.54206.157399447740234&type=1&theater

Komuna Karposh

Sipërfaqja	35 км^2
Numri i banorëve	59,666
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (88,51%), Shqiptarë (3,27%), Serbë (3,66%), Romë (1,03%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	23
Buxheti për vitin 2012	1,768,402,000
Adresa	rr. "Demir Trajko" nr. 43, 1000 Shkup
Telefoni	02/ 2 3 069 799; 02/ 3 061 734; 02/ 3 066 498
Faqja e Internetit	http://www.karpos.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË KARPOSH

Aleksandar Georgievski (PSDM)

Andrej Petrov (LSDM)[57] aktualisht është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, ku është anëtar i Komisionit për Shëndetësi. Funksionin e deputetit e ushtron tanimë 5 vjet, ndërsa paraprakisht nga viti 2003 deri në vitin 2008 ka qenë kryetar i Komunës Karposh. Nga viti 1996 deri në vitin 2003 punon në Klinikën për Dermatovenerologji. Ai gjithashtu është edhe specialist-konsulent në Spitalin "Remedika" në Shkup. Ka diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup dhe ka specializuar në të njëjtin fakultet për dermatovenerologji. Petrov ka 41 vjet.

[57] https://www.facebook.com/PetrovAndrej

Jagnula Kunovska (VMRO-DPMNE) është avokate në pension. Ajo është pjesë e themeluesve të Lëvizjes për Aksion Panmaqedonas (MAAK) në vitin 1990, ndërkaq në vitin 2006 u zgjodh për deputete në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë si kandidate nga radhët e Partisë së Re Social-Demokrate (PRSD). Gjatë vitit 2007 nga PRSD-ja kalon në radhët e VMRO-DPMNE. Ka kryer Fakultetin Juridik në Shkup dhe ka magjistruar në fushën e të drejtës penale. Ka botuar një numër të madh të librave me poezi, ndërsa merret edhe me pikturë. Ajo është anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë. Jagnulla Kunovska është 70 vjeçare.

Nebojsha Davidovski (USD)

Stevço Jakimovski (PPSM)[58] e ushtron mandatin e tij të dytë si kryetar i Komunës Karposh. Mandatin e parë si kryetar komune e ushtroi gjatë periudhës kohore 2000 deri më 2003. Në vitin 2003 është emëruar për ministër të Ekonomisë, ndërkaq nga dhjetori i viti 2004 e ushtron funksionin e Ministrit të Punës dhe Politikës Sociale. Pas përfundimit të mandatit të ministrit punon në firmën e tij private. Para fillimit të karrierës politike është marrë me biznes privat, ndërkaq në vitin 1992 bëhet drejtor i "Katllanovo Turs". Jakimovski ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik në Shkup. Ka 52 vjet.

[58] http://apostolka.com/stevce-jakimovski-proglasen-za-najdobar-gradonacalnik-vo-jugositocna-i-sredna-evropa/#.USypNTBIXPU

Komuna Kisella Vodë

Sipërfaqja	47 km^2
Numri i banorëve	57,236
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (91,69%), Serbë (2,49%), Romë (1,25%), Vlleh (1,13%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	23
Buxheti për vitin 2012	1,021,543,478
Adresa	Rr. "Prvomajska" p.n., 1000 Shkup
Telefoni	02/ 3 785 400
Faqja e Internetit	http://www.kiselavoda.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNA KISELLA VODË

Biljana Beliçanec Aleksiq (VMRO-DPMNE) punon si aktore në Teatrin Dramaturgjik – Shkup nga viti 1997. Paraprakisht ka punuar në Teatrin Popullor "Vojdan Çernodrinski" – Prilep. Deri më tani ka realizuar një sërë rolesh kryesore dhe sporadike në më shumë projekte teatrale në Teatrin Dramaturgjik dhe institucione e projekte të tjera. Ka diplomuar në fakultetin e Arteve Dramatike në Shkup si aktore më e re. Ka 39 vjet.

Lupço Vasovski (LSDM)[59] punon si drejtor operativ për shitje me pakicë në Kompaninë "TINEKS". Në këtë pozitë është tanimë 18 vjet, që nga themelimi i kësaj kompanie. Paraprakisht ka punuar si drejtor komercial në firmën "Interprogres". Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik në Shkup. Në mënyrë aktive plot 20 vjet merret me basketboll dhe është anëtar i Këshillit Drejtues të Federatës së Basketbollit të Republikës së Maqedonisë. Ka 53 vjet.

Sasho Jovanoski (PSDM)

Tatjana Gjorshievska (USD)

[59] https://www.facebook.com/LjupcoVasovskizaKiselaVoda?fref=ts

Komuna Saraj

Sipërfaqja	241 km^2
Numri i banorëve	35,408
Struktura etnike e popullsisë	Shqiptarë (91,53%), Maqedonas (3,89%), Boshnjakë (3,16%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	19
Buxheti për vitin 2012	370,000,000
Adresa	Qendra Rekreative Saraj p.n., Komuna Saraj
Telefoni	02/ 2 057 990; 02/ 2 057 996
Faqja e Internetit	http://www.saraj.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË SARAJ

Azbi Nuredini (PDSH)

Bekim Murati (BDI)[60] e ushtron mandatin e tij të parë si kryetar i Komunës Saraj në të cilin u zgjodh në zgjedhjet e parakohshme lokale të vitit 2011. Nga viti 2002 ka punuar si gazetarë në më shumë media të shtypura dhe elektronike në Maqedoni. Ka kryer studime për Komunikologji në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Ka 32 vjet.

Blerim Halimi (RDK)

Zoran Boshkovski (VMRO-DPMNE) në të kaluarën ka punuar si gazetar, ndërsa nga viti 1997 punon në Shkollën Fillore "Gjorçe Petrov" si mësimdhënës i gjuhës maqedonase. Në vitin 2006 është emëruar drejtor i kësaj shkolle. Njëkohësisht, është edhe autor i disa publikimeve. Ka diplomuar në Fakultetin Filologjik në Shkup. Ka 45 vjet.

[60] http://www.utrinski.com.mk/default.asp?ItemID=94966CC74DD05B4A979FB4CE6FA3F416

Komuna Qendër

Sipërfaqja	10 км^2
Numri i banorëve	45,412
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (85,39%), Serbë (4,49%), Shqiptarë (3,23%), Romë (2,14%), Turq (1,08%), Vlleh (1,01%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	23
Buxheti për vitin 2012	486,530,000
Adresa	Rr. "Mihail Cokov" p.n., 1000 Shkup
Telefoni	02/ 3 203 600
Faqja e Internetit	http://www.opstinacentar.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË QENDËR

Andrej Zhernovski (PLD)[61] është kryetar i Partisë Liberal Demokratike. Në periudhën kohore 9 vjeçare, nga viti 2002 deri në vitin 2011 ka qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe pas kësaj është zgjedhur për kryetar të PLD-së. Në periudhën, nga viti 1996 deri në vitin 2000, ka qenë këshilltar në Këshillin e Qytetit të Shkupit dhe zëvendës kryesues, ndërsa në dy vitet e ardhshëm ka qenë këshilltar i kryetarit të Qytetit të Shkupit. Ka diplomuar në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Shkup. Ka 44 vjet.

[61] http://ldp.org.mk/PresoviSoopstenija.asp?rb=466

Vladimir Todoroviq (VMRO-DPMNE) e ushtron mandatin e tij të parë si kryetar i Komunës Qendër. Ai është themelues dhe drejtor ekzekutiv i Kompanisë "Tineks". Todoroviq investon dhe e mbështet Klubin Hendbolistik "Prolet". Ai është kryetar i Rotari-Klubit – Shkup në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2006, gjithashtu është kryetar edhe i Dhomës Tregtare dhe anëtar i Bordit Drejtues të Lidhjes së Dhomave Ekonomike. Ka diplomuar në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Shkup. Ka 56 vjet.

Gorica Trajkovska (PSDM)

Cute Trajçeski (USD)

Komuna Çair

Sipërfaqja	4 км^2
Numri i banorëve	64,773
Struktura etnike e popullsisë	Shqiptarë (57,00%), Maqedonas (24,13%), Turq (6,95%), Romë (4,76%), Boshnjak (4,55%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	27
Buxheti për vitin 2012	858,090,420
Adresa	Bul. "Hristijan Todorovski" nr.. 5, 1000 Shkup
Telefoni	02/ 5 101 855
Faqja e Internetit	http://cair.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË ÇAIR

Besnik Telai (kandidat i pavarur)[62] është profesor në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe në Universitetin Shtetëror në Prishtinë. Paraprakisht ka punuar si mësimdhënës i kulturës fizike në Shkollën Fillore "25 Maj" në Shkup. Ka diplomuar dhe magjistruar në Fakultetin e Kulturës Fizike në Shkup, ndërkaq më vonë në fakultetin e njëjtë e ka fituar edhe titullin Doktor i shkencave. Ka 50 vjet.

Gikten Haziri (RDK) punon në Ministrinë e Kulturës nga viti 2007 si udhëheqës i Seksionit për zhvillim kulturor dhe politika kulturore. Paraprakisht, në periudhën 2005 deri në vitin 2007, ka punuar në Sektorin për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Ka magjistruar dhe doktoruar në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe politikës ndërkombëtare në Fakultetin Juridik në Shkup. Ka 53 vjet.

[62] http://www.unitesport.edu.mk/stafiakademik/profesoret/61-profesoret/6-besnik-telai.html

Izet Mexhiti (BDI)[63] aktualisht e ushtron mandatin e tij të dytë si kryetar i Komunës Çair. Para se të zgjidhet për kryetar komune ka punuar në "Postat e Maqedonisë" dhe si profesor në SHMQSH "Arsenij Jovkov" në Komunën Butel. Për momentin është magjistrant në Fakultetin Ekonomik në Shkup, në të cilin paraprakisht ka diplomuar në vitin 2000. Ka 36 vjet.

Marija Angelova (VMRO-DPMNE) është drejtoreshë e Kopshtit për Fëmijë "Snezhana" në Shkup. Në periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2010 ka qenë mësimdhënëse e mësimit klasor në Shkollën Fillore "Vëllezërit Ramiz dhe Hamid" në Çair, ndërsa paraprakisht ka punuar në Ministrinë e Mbrojtjes. Në periudhën nga viti 1999 deri në vitin 2002 ka punuar në firmën "Euro Interneshënël Korp dhe King Star". Angellova është pajisur me diplomë të Fakultetit Pedagogjik në Shtip për mësimdhënëse të mësimit parashkollor dhe për mësim klasor nga Fakulteti Pedagogjik "Shën Klimenti i Ohrit" në Shkup. Angellova gjithashtu ka magjistruar në shkencat nga fusha e menaxhmentit të resurseve njerëzore. Ka 32 vjet.

Muhamed Thaçi (PDSH)

Trajçe Nedellkovski (LSDM)[64] është inspektor i pensionuar i krimit të dhunshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në MPB ka punuar 36 vjet, nga vitit 1976 deri në vitin 2012. Ka diplomuar në Fakultetin Teknik në Manastir, Dega inxhinier i komunikacionit. Ka 54 vjet.

[63] http://www.utrinski.com.mk/?ItemID=2A93E6FF84A0EF4EA93CCF033C7FBD8F
[64] https://www.facebook.com/photo.php?fbid=268240703310468&set=a.267154986752373.1073741825.267154206752451&type=1&theater

Komuna Shuto Orizarë

Sipërfaqja	7 км^2
Numri i banorëve	22,017
Struktura etnike e popullsisë	Romë (60,60%), Shqiptarë (30,32%), Maqedonas (6,53%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	19
Buxheti për vitin 2012	193,366,349
Adresa	Rr. "Vietnamska" p.n., 1000 Shkup
Telefoni	02/ 2 650 584
Faqja e Internetit	http://www.sutoorizari.org.mk

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË SHUTO ORIZARË

Elvis Bajram (Lidhja e Romëve) është kryetar aktual i Komunës Shuto Orizarë. Para se të bëhet kryetar i komunës ka qenë kryetar i Këshillit të Komunës Shuto Orizarë. Merret me biznes familjar. Ka kryer arsim fillor. Ka 36 vjet.

Ibraim Suma (PDSH)

Nezhdet Mustafa (Partia e Bashkuar për/FBDR)[65] është ministër pa resor në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe koordinator i Dekadës për Përfshirjen e Romëve 2005-2015 dhe i Strategjisë Nacionale të Romëve. Këtë funksion e ushtron nga viti 2008. Paraprakisht, nga viti 2002 deri në vitin 2008 ka qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Në dy mandate, nga viti 1996 deri në vitin 2002 ka qenë kryetar i Komunës Shuto Orizarë. Para mandatit si kryetar i Komunës tre vjet ka qenë redaktor i Programit rom në Radiotelevizionin e Maqedonisë. Mustafa ka diplomuar për filozofi në Fakultetin Filozofik në Shkup. Ka 50 vjet.

[65] http://vlada.mk/clenovi/nezdet-mustafa

Komuna Manastir

Sipërfaqja	792 км^2
Numri i banorëve	95,385
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (88,71,%), Shqiptarë (4,36 %)
Numri i anëtarëve të Këshillit	31
Buxheti për vitin 2012	1,379,732,776
Adresa	Bulevardi "1 Maji", nr. 61, 7000 Manastir
Telefoni	047/234-234
Faqja e Internetit	http://www.bitola.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË MANASTIR

Afrim Selimi (PDSH)

Vlladimir Talevski (VMRO-DPMNE) e ushtron mandatin e tij të dytë si kryetar i Komunës Manastir. Deri në zgjedhjen e tij për kryetar të komunës, në vitin 2005, ka punuar si aktor në Teatrin e Manastirit dhe ka luajtur në shumë shfaqje teatrale, TV novela dhe filma artistik. Gjithashtu, ka bërë regjinë e shfaqjeve teatrale dhe dokumentarëve televiziv. Talevski është aktor i diplomuar, ndërkaq ka specializuar për regji teatrale në Sofje dhe ka magjistruar për regji teatrale në Shkup. Ka 53 vjet.

Zoran Llazaroski – Palo (kandidat i pavarur) është pronar i fitnes klubit në Manastir tanimë plot 17 vjet. Paraprakisht ka punuar në shumë vende të botës. Që në moshë të re është marrë me sport, fillimisht me çiklizëm, më vonë me karate dhe bodi-bilding, ku ka arritur rezultate të konsiderueshme. Llazarevski është shkolluar në qytetin e tij të lindjes në Manastir. Ka 52 vjet.

Jorgo Ognenovski (kandidat i pavarur) është aktor profesional. Ka themeluar firmë për produksion të filmave, TV novelave dhe për tërheqjen e shtëpive të produksionit nga Holivudi. Gjithashtu, është themelues edhe i Organizatës Humanitare "Për shëndet më të mirë" – Manastir, e cila u dedikohet nevojave të spitalit në Manastir. Paraprakisht ka prodhuar 4 filma artistik në Holivud, SHBA nga të cilët njëri në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të Republikës së Maqedonisë. Ognenovski e aktron njërin nga rolet kryesore në atë film. Është themelues i Kompanisë "Uorldsings" në Burbank, Kaliforni, SHBA e cila ka për qëllim ta promovojë, në mbarë botën, turizmin në Maqedoni, veçanërisht rajonin e Ohrit dhe të Manastirit. Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik në Shkup. Ka 58 vjet.

Liljana Nasteska (PSDM)

Lubomir Gruevski (LPM)[66] është poet maqedonas. Për momentin është kryeredaktor në Shtëpinë Botuese "Misirkov", e cila është shtëpia e parë botuese në Maqedoni jashtë kryeqytetit. Gruevski e ka themeluar dhe njëkohësisht është drejtor i kësaj Shtëpie botuese. Paraprakisht ka punuar si redaktor në shtëpi të tjera botuese, drejtor i "Heraklea Linkestis", dhe drejtor i Teatrit Popullor në Manastir. Ka studiuar dhe ka diplomuar për letërsi në Fakultetin Filologjik në Beograd dhe në Fakultetin Filozofik në Shkup. Ka 64 vjet.

[66] http://emirsokolovic.com/gallery/vi-me-unarodni-poetski-festival-heraklea-2011-bitola-makedonija

Mende Dinevski (LSDM)[67] aktualisht është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga viti 2008. Nga viti 2002 deri në vitin 2008 ka punuar si stomatolog në Shtëpinë e Shëndetit Publik në Manastir. Si deputet është kryetar i Komisionit për Shëndetësi, ndërsa është anëtar i Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Komisionit për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive dhe i Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve. Dinevski është doktor i stomatologjisë dhe specialist për kirurgji orale. Ka 39 vjet.

Xhoko Damevski (USD)

[67] http://www.mendedinevski.mk/

Komuna Veles

Sipërfaqja	464 км^2
Numri i banorëve	55,108
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (84,86%), Shqiptarë (4,17%), Turq (3,13%), Romë (1,45%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	23
Buxheti për vitin 2012	722,263,477
Adresa	"Panko Brashnar" nr. 1, 1400 Veles
Telefoni	043/232-966
Faqja e Internetit	http://www.veles.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË VELES

Ace Kocevski (LSDM) është pronar dhe drejtor i Shoqërisë për Ndërtimtari dhe Shërbime Konsulente AFION-Veles. Paraprakisht, Kocevski ka qenë kryetar i Komunës Veles edhe atë në dy mandate nga viti 2000 deri në vitin 2009, nënsekretar në Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale nga viti 1999 deri në vitin 2000. Ai ka qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën kohore nga viti 1994 deri në viti 1998. Gjatë studimeve ka qenë në organizatën rinore të Universitetit "Shën Cirili e Metodi" nga viti 1982 deri në vitin 1983. Ka diplomuar për inxhinier të ndërtimtarisë. Ka 51 vjet.

Matjan Spasovski (USD)

Sllavo Çadiev (VMRO-DPMNE) është anëtar dhe kryetar i Këshillit të Komunës Veles në dy mandate, përkatësisht nga viti 2005 deri më sot. Çadiev është magjistër për defektologji- surdolog dhe punon në ISHP Spitalin e Përgjithshëm Veles, repartin ORL. Ai është nënkryetar i Lidhjes së Defektologëve në Maqedoni, bashkëpunëtorë shumëvjeçar i Lidhjes së Personave të Shurdhër dhe me Dëgjim të Kufizuar të Republikës së Maqedonisë dhe i Entit për Persona të Shurdhër "Koço Racin"-Manastir, si dhe në degët e Lidhjes së Personave të Shurdhër dhe me Dëgjim të Kufizuar dhe Lidhjes së Personave të Verbër në Veles. Ka diplomuar në Fakultetin e Defektologjisë në Beograd. Ka 54 vjet.

Tanja Petrovska (PSDM)

Komuna Gjevgjeli

Sipërfaqja	485 км^2
Numri i banorëve	22,988
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (96,82%), Serbë (1,60 %)
Numri i anëtarëve të Këshillit	19
Buxheti për vitin 2012	511,208,660
Adresa	"Dimitar Vllahov" nr. 4, 1480 Gjevgjeli
Telefoni	034/213-899
Faqja e Internetit	http://gevgelija.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GJEVGJELI

Ivan Frangov (VMRO-DPMNE) e ushtron mandatin e tij të parë si kryetar i Komunës Gjevgjeli. Paraprakisht, nga viti 2007 ka punuar si udhëheqës në Seksionin tatimor në Drejtorinë për të Ardhura Publike në Gjevgjeli. Nga viti 2002 deri në vitin 2007 ka punuar në kompaninë private "Sollun 53" SHA Gjevgjeli, së pari si udhëheqës në market, ndërsa më pas si anëtarë ekzekutiv i Bordit të Drejtorëve. Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik në Shkup, Drejtimi tregtia e Jashtme dhe Marketing. Ka 43 vjet.

Jovan Platanski (PSDM)

Petar Eftimov (USD)

Save Maraçkov (LSDM)[68] aktualisht është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga viti 2011. Ai është anëtar i Komisionit për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit dhe i Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave. Maraçkov është inxhinier i diplomuar i pylltarisë. Ka 46 vjet.

[68] http://www.sobranie.mk/?ItemID=769677A13C93A14B8AA437CBB0C39219

Komuna Gostivar

Sipërfaqja	519 км^2
Numri i banorëve	81,042
Struktura etnike e popullsisë	Shqiptarë (66,68%), Maqedonas (19,59%), Turq (9,86%), Romë (2,76%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	31
Buxheti për vitin 2012	962,700,000
Adresa	"Braqa Ginoski" nr. 61, 1230 Gostivar
Telefoni	042/213-511
Faqja e Internetit	http://www.gostivari.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GOSTIVAR

Zoran Angelov (LSDM)[69] është profesor i lëndëve profesionale të makinerisë në shkollën e mesme teknike në Gostivar nga viti 2001. Ka diplomuar në Fakultetin e Makinerisë. Ka 43 vjet.

Miat Sadiku (PDSH)[70] me profesion është elektroinxhinier.

Nevzat Bejta (BDI)[71] nga viti 2011 deri në shkurt të vitit 2013 ishte Ministër i Vetëqeverisjes Lokale në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Në vitin 2005 u zgjodh për kryetar të Komunës Gostivar dhe nënkryetar i BNjVL. Në periudhën nga viti 2002 deri në vitin 2005 ishte deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Në vitin 2000 u zgjodh për këshilltar në Këshillin e Komunës Gostivar. Paraprakisht ka punuar si profesor i historisë në fshatin Çegran dhe në Gostivar. Ka diplomuar në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, në Katedrën e Historisë dhe ka magjistruar në Universitetin e Tiranës. Ka 51 vjet.

[69] http://a1on.mk/wordpress/archives/113629
[70] http://dnevnik.com.mk/default.asp?ItemID=5B94516126CA094281A6BB9867DD9248
[71] http://mls.gov.mk/index.php?news=5

Rufi Osmani (RDK) është kryetar i Komunës Gostivar nga viti 2009, ndërsa njëkohësisht është themelues dhe kryetar i partisë Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK). Deri në vitin 2009 ka qenë profesor në Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL), ndërsa nga viti 1994 deri në vitin 2003 ka qenë ligjërues në Universitetin e Tetovës.

Në vitin 1994 është zgjedhur për deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, ndërkaq në vitin 1996 zgjidhet për kryetar të Komunës Gostivar, funksion të cilin e ushtron deri në muajin prill të vitit 1997. Në atë vit është burgosur dhe e vuan dënimin me burgim për shkak të mosrespektimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për mosvendosjen e flamujve të bashkësive etnike. Në vitin 1999 është liruar në bazë të Ligjit për amnisti. Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë dhe më vonë bëhet Doktor i shkencave ekonomike. Ka publikuar një numër të madh të punimeve publicistike dhe shkencore. Ka 52 vjet.

Sasho Aqimovski (VMRO-DPMNE) punon në SHA "ELEM" Njësia Punuese "Hec Mavrovë" – Gostivar. Ai është përgjegjës për punën financiare dhe komerciale në këtë kompani. Paraprakisht ka punuar si drejtor i Inspektoratit Shtetëror të Tregut, udhëheqës i Njësisë Rajonale të FSSH Gostivar dhe si zëvendësdrejtor në ndërmarrjen për shfrytëzimin dhe rregullimin e truallit ndërtimor NP Gostivar. Ka 37 vjet.

Komuna Dibër

Sipërfaqja	145,67 км^2
Numri i banorëve	19,542
Struktura etnike e popullsisë	Shqiptarë (58,07%), Maqedonas (20,01%), Turq (13,73%), Romë (5,53)
Numri i anëtarëve të Këshillit	15
Buxheti për vitin 2012	250,643,000
Adresa	"8 Shtator" nr. 72, 91250 Dibër
Telefoni	046/831-015
Faqja e Internetit	

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË DIBËR

Ibraim Kolari (kandidat i pavarur)[72] është pronar i firmës për beton të gatshëm. Ka punuar dhe jetuar në SHBA, ndërsa pas kthimit ka investuar në Firmën NN "Korabi" aktualisht "Korbai redi mijs". Në vitin 2012 e ka fituar çmimin për filantrop individual nga diaspora të cilin e ndan Qendra për Zhvillim Institucional – QZHI. I ka bërë donacione Bashkësisë Islame të Maqedonisë dhe Kishës Ortodokse Maqedonase, si dhe për aktivitete sportive dhe kulturore.

Mexhit Dika (PDSH) është inxhinier i pensionuar i makinerisë. Ka 66 vjet.

[72] http://www.facebook.com/ibrahim.kolari

Ruzhdi Lata (BDI) është ligjërues në Katedrën e Filologjisë Orientale në Universitetin Shtetëror të Tetovës nga viti 2009 dhe Myfti i Myftinisë së Dibrës. Në Bashkësinë Islame të Maqedonisë punon nga viti 1995, ndërsa në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup ka punuar nga viti 1993 deri në vitin 1995 dhe sërish nga viti 2009 e deri më sot. Nga viti 1980 deri në vitin 1991 punon në Bashkësinë Islame dhe në Universitetin e Prishtinës. Ka përkthyer vepra nga arabishtja dhe turqishtja, por gjithashtu ka publikuar edhe vepra të veta. Ka diplomuar në Katedrën për Gjuhë Orientale në Fakultetin Filologjik të Universitetit në Prishtinë ku edhe ka magjistruar në shkencat filologjike. Ka 59 vjet.

Komuna Dellçevë

Sipërfaqja	423 km^2
Numri i banorëve	17,505
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (95,04%), Romë (3,72%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	15
Buxheti për vitin 2012	221,695,160
Adresa	"Metodi Mitevski Brico" nr. 40, 2320 Dellçevë
Telefoni	033/411-550
Faqja e Internetit	http://www.delcevo.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË DELLÇEVË



Gollub Angellov (LSDM)[73] aktualisht është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga viti 2011. Si deputet është anëtar i Komisionit për Mundësi të Barabarta të Meshkujve dhe Femrave. Në periudhën kohore nga viti 2007 deri në vitin 2011 ka punuar në organizatën komunale të LSDM-së në Dellçevë, ndërsa 4 vitet paraprak ka qenë profesor i sociologjisë dhe kulturës qytetare në SHMK "Aco Ruskovski", Berovë. Ka diplomuar për sociologji në Fakultetin Filozofik në Shkup dhe për momentin është në studime të magjistraturës në fushën e sigurisë ndërkombëtare. Ka 36 vjet.

Darko Shehtanski (VMRO-DPMNE) punon në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave të RM-së. Paraprakisht, nga viti 1991 deri në vitin 2001, ka punuar në firmën e tij private "Almak" – Dellçevë. Ka diplomuar për inxhinier të energjetikës. Ka 46 vjet.

73 http://www.sobranie.mk/?ItemID=CF8E55AA84CABC498933C1D4F0AE4874

Zllatko Peshov (USD)

Zoran Makedonski (kandidat i pavarur)[74] është inxhinier i diplomuar i makinerisë. Për momentin është i papunë. Ka 26 vjet.

Kirço Gocevski (PSDM)

[74] http://www.kanal5.com.mk/Default.aspx?mId=120

Komuna Kavadar

Sipërfaqja	1132 км^2
Numri i banorëve	38,741
Struktura etnike e popullsisë	Maqedonas (96,79%), Romë (1,75%)
Numri i anëtarëve të Këshillit	19
Buxheti për vitin 2012	690,242,330
Adresa	"Mareshali Tito" p.n. K. Postare 184, 1430 Kavadar
Telefoni	043/416-107
Faqja e Internetit	http://www.kavadarci.gov.mk/

KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË KAVADAR

Aleksandar Panov (VMRO-DPMNE) aktualisht është kryetari Komunës Kavadar. Para se të zgjidhet për kryetar Komune, nga fundi i vitit 2008 deri në vitin 2009 ka qenë udhëheqës i NP "Postat e Maqedonisë" -Filiali në Kavadar. Në periudhën nga viti 1999 deri në vitin 2009 ka punuar në NP "Komunalec" – Kavadar si jurist, referent për përfaqësim dhe paditje. Nga viti 2005 deri në vitin 2009 ishte anëtar i Këshillit dhe koordinator i grupit të këshilltarëve të VMRO-DPMNE në Komunën Kavadar. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Shkup. Ka 43 vjet.

Betian Kitev (LSDM) aktualisht është këshilltar në Komunën Kavadar. Në muajin tetor të vitit 2008 ka diplomuar në Katedrën për Studime Politike në Fakultetin Juridik në Shkup, ndërkaq aktualisht është magjistrant në fakultetin e njëjtë. Ka 27 vjet.



Boris Davidov (kandidat i pavarur) aktualisht është këshilltar në Komunën e Kavadarit. Më shumë vjet ka punuar si profesor, ndërsa më pas është marrë me biznes privat, duke tregtuar me Turqinë dhe Kinën. Paraprakisht ka punuar si oficer në Pullë, ndërsa më vonë në organet e administratës në Kavadar. Ka diplomuar në Akademinë Ushtarake në Beograd. Ka 66 vjet.

